



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIKSIONIT**  
**TË PËRGJITHSHËM**  
**DURRËS**

**ANALIZA VJETORE E PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË**  
**SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS**

**VITI 2023**

## PËRMBAJTJA

<b>I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 .....</b>	<b>6</b>
1. Të dhëna dhe shpjegime për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë....	6
2. Rritja e rolit aktiv të prokurorit, në fillimin/regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe kryerjen e hetimeve proaktive .....	8
3. Mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.....	8
4. Mbi zbatimin e Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet në Rezolutën e Kuvendit.....	10
5. Mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe si kanë ndikuar në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara. ....	13
6. Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal .....	16
7. Të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe dëshmitarë .....	16
8. Grupet vulnerabël të pandehur dhe viktima.....	18
9. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe zbatimi i akteve/marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, me KLSH, me ILDKPKI, etj. ....	19
10. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe/ose nëpërmjet prokurorit ndërlidhës shqiptar në EUROJUST .....	21
11. Të dhëna për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre.....	22
12. Problematikat e hasura.....	25
<b>II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë.....</b>	<b>27</b>
1. Volumi i punës në hetim.....	27
2. Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....	28
3. Treguesit kryesor të punës së prokurorisë .....	29
4. Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.....	31
5. Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror .....	32
6. Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	33
7. Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencat e tyre .....	36
8. Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal.....	38
<b>III. Treguesit statistikorë 2-vjeçar të veprave penale sipas strukturës së kodit penal.....</b>	<b>41</b>
<b>IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë .....</b>	<b>72</b>
1. Treguesit e efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale, raporti i çështjeve dhe të pandehurve të dërguara me kërkesë për gjykim me ato të pushuara, dhe raporti i çështjeve të pezulluara me çështjet e përfunduara në hetimevt paraprake .....	72
2. Treguesit e efektivitetit në gjykim dhe në dënimin e të pandehurve .....	72
3. Të dhëna për gjykimet e posaçme.....	73

4. Të dhënat mbi llojet dhe masat e dënimeve.....	74
6. Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit.....	76
6. Të dhënat për pasojat e veprave penale .....	78
<b>V. Të dhënat lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....</b>	<b>79</b>
<b>VI. Të dhënat për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore.</b>	<b>82</b>
<b>VII. Informacion mbi administrimin dhe veprimtarinë administrative të prokurorisë...</b>	<b>85</b>
<b>IX. Informacion për marrëdhëniet me publikun dhe mediat.....</b>	<b>88</b>
<b>X. Objektivat sipas drejttimeve në veprimtarinë administrative dhe funksionale të prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 dhe rekomandime.....</b>	<b>88</b>

## HYRJJE

Në zbatim të detyrimeve që përcakton ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, paraqes përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, analizën vjetore të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për vitin 2023.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës gjatë vitit 2023 ka patur në organikën e saj një numër prej 34 prokurorësh, ku përfshihen një Drejtues, një Zëvendës Drejtues dhe 32 prokurorë sektori, por numri faktik I prokurorëve gjatë vitit 2023 ka qenë 21 nga të cilët dy kanë qenë të komanduar në Prokuroritë e Apelit dhe tre prokurorë të shkarkuar nga KPK-ja. Po kështu dhe 22 oficerë të policisë gjyqësore. Për vitin 2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka operuar me 16 prokurorë pra 4 prokurorë më pak se një vit më parë.

Nëpërmjet këtij materiali do të paraqesim treguesit e punës së veprimtarisë së përgjithshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, realizuar gjatë vitit 2023, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin paraprak dhe në gjykim si dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore nga Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Po kështu do të paraqesim në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës, ecurinë, progresin, por dhe mangësitë e konstatuara në punën tonë, zgjidhjet ligjore të dhëna dhe hapat e hedhura për zhvillimin dhe përmirësimin e standarteve në punë, performancën e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nëpërmjet analizës vjetore të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, do të ndalemi në mënyrë të përgjithshme, të përmbledhur, por dhe të detajuar në aspekte të veçanta të gjithë treguesve lidhur me veprimtarinë e punës për periudhën njëvjeçare. Informacioni përmban të dhëna mbi numrin e çështjeve dhe materialeve kallëzuese të regjistruara, mënyrën e zgjidhjes ligjore të tyre, numrin e çështjeve të mbartura nga viti i kaluar, por dhe ecurinë e çështjeve të dërguara gjykatës, etj.

Në një vlerësim paraprak, nisur nga të dhënat që do të analizojmë në mënyrë të detajuar, elementi i parë që evidentohet dukshëm është se gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka përballuar ngarkesë të lartë pune. Kështu në raport me vitin 2022, gjatë vitit 2023 janë trajtuar në total **6844** materiale hetimore, nga **6074** materiale hetimore të trajtuara në vitin 2022, me një rritje në masën **12.67%**.

Gjatë trajtimit të këtyre materialeve është konkluduar dhe më pas është vendosur regjistrimi i procedimeve penale për **2687** procedime, në krahasim me vitin 2022 ku janë regjistruar **2290** procedime. Konstatohet se kemi rritje në masën **17.33%** të regjistrimeve për procedimet penale krahasuar me vitin 2022.

Në vitin 2023 është vendosur mosfillimi për **1992** materiale kallëzuese, ndërsa për vitin 2022 janë mosfilluar **1806** materiale kallëzuese. Krahasuar me vitin 2022 rezulton se kemi një rritje prej **10.29%** të materialeve hetimore për të cilat prokurorët kanë vendosur mosfillimin e procedimeve penale. Gjithashtu janë arshivuar 638 materiale në kudër të Memorandumit të Bashkëpunimit.

Pra, siç vërehet nga të dhënat e sipërcituara rezulton që të kemi rritje në treguesit e ngarkesës së punës, siç është numri i çështjeve të regjistruara, numri i çështjeve të dërguara për gjykim është në rritje në krahasim me një vit më parë, 1043 kundrejt 985 çështjeve, gjithashtu edhe numri i çështjeve të përfunduara në total është 2545 (nga të cilat 314 çështje i përkasin ish-Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë) krahasuar me 2508 për vitin 2022. Në total numri i çështjeve në hetim për vitin 2023 është 4852 kundrejt 4268 për vitin 2022.

Pavarësisht nga të dhënat që do të prezantohen, jemi të vetëdijshëm se duhet të merren masa të tjera të domosdoshme për të garantuar rritjen e suksesit në luftën kundër krimit, duke kërkuar mbështetje dhe në strukturat e tjera ligjzbatuese të shtetit.

Mënyra më sintetike e përshkrimit të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në ushtrimin e funksioneve të saj është parashtrimi i të dhënave nëpërmjet shifrave, prandaj më lejoni t'Ju paraqes të grupuara treguesit e punës për periudhën njëvjeçare, shtrirjen dhe tendencat e kriminalitetit.

## I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës gjatë vitit 2023 është fokusuar në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë duke patur në fokus të saj ndëshkimin e veprave penale të pastrimit të produkteve të veprave penale, kundër lëndëve narkotikëve, krimeve kundër jetës shëndetit dhe fenomeneve të tjera në shkelje të ligjit.

Qëllimi i punës së të gjithë prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka qenë rritja e standarteve të hetimit të procedimeve penale si dhe mbrojtja e akuzës në gjykatë duke kërkuar forcimin e profesionalizmit dhe integritetit të prokurorëve. Drejtimi dhe përparësitë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në luftën kundër kriminalitetit kanë qenë të fokusuar kryesisht në:

### 1. Të dhëna dhe shpjegime për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë

Drejtimet kryesore të luftës kundër kriminalitetit për vitin 2023, të cilat janë të formalizuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave dhe Rezolutës së Kuvendit për vitin 2023, janë ndjekur me përparësi nëpërmjet masave administrative sic janë zbatimi i udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm<sup>1</sup> dhe miratimi i Planit të Veprimit me qëllim rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, për përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor të prokurorisë, për forcimin e ligjshmërisë, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit nëpërmjet rolit aktiv të prokurorit për kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose fillimin/regjistrimin e procedimeve kryesisht, ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e çështjeve/akuzave në gjyq, për krime të rënda e sensitive, me shtrirje të gjerë e me tendencë në rritje, dhe marrjen e masave për vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe respektimin e të drejtave të ligjshme dhe lirive personale të individit në procesin penal, ashtu dhe për përmirësimin e koordinimit dhe monitorimit të veprimtarisë së prokurorëve dhe policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve në strukturat hetimore përkatëse, si dhe për përmirësimin e performancës dhe mbarëvajtjes së punës administrative dhe funksionale në Prokurorinë e Durrësit.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës përveç këtyre rekomandimeve ka patur në objektivat e saj të punës edhe disa prioritete të cilat diktohen nga vecoritë dhe natyra e veprave penale që ndodhin në këtë rreth gjyqësor sic janë ndjekja me përparësi e procedimeve penale që kanë të bëjnë me trafikimin e lëndëve narkotike, kontrabanda e naftës, dhuna në familje etj.

Lidhur me masat e marra për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprave penale, krimin financiar dhe hetimeve pasurore, efikasitetin në bashkëpunimin ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatuese të përfshira dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve në seksionet e posaçme, për hetimet proaktive të pastrimit të parave, për identifikimin dhe sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive/produkteve kriminale ose vlerave ekuivalente të tyre, dhe për një politikë penale më efektive në këtë fushë, ashtu dhe për rezultatet e arritura, në zbatim të këtij objektiwi prioritar të prokurorisë, udhëzimeve të përgjithshëm nr. 10/2020 dhe nr.2/2022, rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit dhe planit të veprimit për zbatimin e saj, rekomandimeve prioritare të KM dhe planit të veprimit për zbatimin e tyre, si dhe memorandumit të bashkëpunimit nr.1079/2, datë 15.07.2020, informojmë se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka patur si prioritet të saj gjatë vitit 2023 hetimin e veprave penale të pastrimit të produkteve të veprave penale që lidhen me atë kategori veprash për të cilat kjo prokurori është kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale. Këto kategori veprash penale

<sup>1</sup> Udhëzim I përgjithshëm nr. 2/2023 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

janë hetuar nga Seksioni i Posaçëm krijuar në bazë të Udhëzimit nr. 10/2021 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Me qëllim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Prokurorisë dhe Institucioneve Palë në Memorandum, nga ana jonë janë realizuar takime dhe janë kryer analiza të përbashkëta me qëllim evidentimin e saktë dhe të plotë të rasteve dhe tipologjive të pastrimit të parave dhe krimeve të tjera financiare dhe hetimeve pasurore, me Pikat e Kontaktit dhe oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorive Vendore të Policisë së Shtetit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Seksioni i Posaçëm kundër Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve Pasurore i ngritur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për të gjithë vitin 2023, ka hetuar **96** procedime penale për veprën penale “Pastrimi i Produkteve të Veprës Penale ose Veprimtarisë Kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i K. Penal.

Gjatë vitit 2023, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës janë referuar për veprën penale të pastrimit të parave gjithsej 11 materiale hetimore, njësoj me vitin 2022. Lidhur me procedimet penale për të cilën është ngritur akuzë në Gjykatën e Rrethit, gjithsej janë dërguar me kërkesë për gjykim 2 procedime penale dhe për 5 procedime penale është dërguar kërkesë për pushimin e çështjes.

Pothuajse në çdo rast të hetimit të çështjeve penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, kemi patur bashkëpunim ndërkombëtar nëpërmjet letërporosive për ndihme juridike në fushën penale.

#### *Tipologjite:*

Referimet e kryera nga D.P.Q.Durres, janë përgjithësisht për rastet kur nga autoritetet gjyqësore të huaja janë nxjerrë urdhëra arresti ndërkombëtar apo kanë ardhur kërkesa për ekstradime, njohje vendimesh penale të huaja, për vepra të kryera jashtë shtetit dhe në pak raste për vepra të kryera në R. Shqiperise. Po kështu ka ndonje rast që ka të bëjë me informacione për transaksione të dyshimta nga D.P.P. Parave Tirane.

#### *Problematikat:*

Nga ana e Seksionit të Posaçëm, në lidhje me hetimin e veprave penale të mësipërme, konstatohet se ka probleme në lidhje me anën organizative të policisë gjyqësore. Vihet re lëvizje e shpeshtë e oficerëve të policisë gjyqësore të këtij seksioni pranë D.P.Q.Durres. Evidentimi, gjurmimi dhe hetimi i kësaj lloji veprë kërkon grupe pune të specializuara jo vetëm në fushën e hetimeve penale por edhe në fushën e financave, ekonomisë dhe pasurive të paluajtshme. Sidoqoftë nga ana jonë janë marrë masa që për hetimin e kësaj veprë duke caktuar edhe oficerë të policisë gjyqësore të Seksioneve të Prokurorisë. Vlen të theksohet se nuk ka pasur asnjë rast i cili është referuar për këtë veprë penale nga oficerët e policisë gjyqësore të tatimeve apo doganave, megjithë kërkesat tona të vazhdueshme për referime nga ky burim.

Referimet e kryera nga D.P.Q.Durres, janë përgjithësisht për rastet kur nga autoritetet gjyqësore të huaja janë nxjerrë urdhëra arresti ndërkombëtar apo kanë ardhur kërkesa për ekstradime, njohje vendimesh penale të huaja, për vepra të kryera jashtë shtetit. Në të tjera raste ka sinjalizime nga D.P.P.Parave në Ministrinë e Financave në lidhje me transaksione të dyshimta.

Edhe pse është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e asetëve kriminale, akoma nuk janë ngritur strukturat nga institucionet e tjera.

Vlen te theksohet se në hetimin e këtyre veprave një ndihmesë të konsiderueshme ka dhënë edhe krijimi i zyrës së ekspertëve kontabël pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Në përfundim, konstatohet se autorët e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, kanë filluar të hyjnë në një fazë të re të kryerjes së kësaj vepre penale. Ata nuk mjaftohen me investimin e drejtëpërdrejtë në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të parave që burojnë nga aktivitetet e paligjshme, por tashmë vihen re tendenca në investimet apo krijimin e kompanive private në fusha të ndryshme duke paraqitur aktivitete dhe bilance me fitime të mëdha.

Në lidhje me hetimet pasurore ndaj personave që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr.10192, datë 03. 12. 2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, nga ana Seksionit të Posacëm kunder Pastrimit te Parave, Financimit te Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve Pasurore, janë referuar 22 hetime pasurore.

Lidhur me këtë objektiv, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton të ketë kryer një kërkesë për konfiskim në kuadër të Ligjit Antimafia. Ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal janë kryer dy konfiskime dhe tre sekuestime sipas kërkesave të K.Pr.Penale.

## **2. Rritja e rolit aktiv të prokurorit, në fillimin/regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe kryerjen e hetimeve proaktive**

Prokurorët si drejtues të hetimit, duhet të marrin rolin drejtues që u ngarkon ligji dhe në funksion të hetimeve, të përdorin kërkesat dhe mundësitë ligjore në favor të tyre, duke vepruar në mënyrë proaktive. Kryesisht prokurorët e Seksionit të Posacëm dhe të Seksionit të Trafikeve, në disa raste të hetimit të veprave penale që ndjekin, kanë përdorur metoda speciale të hetimit siç janë përgjimet, vëzhgimet etj.

Në kuadër të këtij prioriteti për vijimin *e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht*, janë nxitur prokurorët për të rritur numrin e procedimeve të filluara kryesisht, nëpërmjet indicieve për vepra penale dhe verifikimin e tyre nga policia gjyqësore e seksioneve në prokurori duke garantuar standartet me të mira të nje procesi të rregullt ligjor.

Për vitin 2023 rezulton të jenë filluar kryesisht 4 procedime penale, një prej të cilave është filluar nga Drejtuesi. Gjithahstu kemi 5 raste të tjera të cilat rezultojnë nga ndarjet e procedimeve nga ana e prokurorëve. Pra, ka rritje në numrin e procedimeve të filluara kryesisht në raport me një vit më parë, si dhe në të njëjtën kohë i është kushtuar rëndësi vërtetësisë së informacionit apo indicieve të bazuara në prova.

Gjatë vitit 2023, prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës rezulton që për një numër prej 81 çështjesh penale janë përdorur metoda speciale të hetimit si përgjime telefonike, përgjime ambientale, infiltrim i punonjësit të policisë së shtetit, kryerje të veprimeve simuluese, etj.

## **3. Mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.**

Lidhur me mbikqyrjen e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, në përmbushje të funksioneve që më janë ngarkuar me ligj, në cilësinë e Drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm



Durrës, vlerësoj se kam patur angazhim maksimal për të garantuar zbatimin korrekt të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga te gjithë prokurorët dhe stafi i kësaj prokurorie.

Konkretisht, menjëherë pas marrjes së Udhëzimeve, urdhërohet kryesekretaria e prokurorisë me shpërndarjen e tyre, te të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe sipas rastit edhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë. Secili prej udhëzimeve punohet në mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve ku merren mendime lidhur me mënyrën e zbatimit të tyre. Nga ana ime udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm janë vlerësuar si të vetzbatueshme dhe nuk kam nxjerrë udhëzime për lehtësimin e zbatimit të tyre. Drejtuesi mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme të detyrueshme vetëm për çështje të organizmit të brendshëm dhe lehtësimin e zbatimit të Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, por jo për çështje të zbatimit të ligjit.

Gjatë vitit 2023 është nxjerrë Plani i veprimit, miratuar me urdhrin nr. 29 datë 08.06.2023 për të siguruar zbatimin e Rekomandimeve Prioritare dhe kërkesat e Rezolutës së Kuvendit. Për secilin nga prioritetet janë parashikuar masa konkrete dhe subjektet që do ti zbatojnë. Përveç, prioriteteve nga ana jonë janë mbajtur parasysh dhe përparësitë e vecanta për rrethin e Durrësit, sic është ndjekja me përparësi e procedimeve penale që kanë të bëjnë me trafikët, pastrimin e parave, kontrabandën e naftës dhe veprat penale që janë më të përhapura në rrethin tonë si dhuna në familje, vjedhjet, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, ngacmimi seksual etj.

Konkretisht janë nxjerrë në total 65 urdhra dhe udhëzime për vitin 2023, që lidhen me çështjet e organizimit dhe funksionimit të prokurorisë (sipas nenit 46 par.4 të ligjit nr.97/2016), “Mbi organizimin e punës sipas seksioneve dhe ndarjen prokuror, oficer të policisë gjyqësore” dhe urdhra “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të administratës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, në varësi të ndryshimeve të organikës së prokurorisë apo administrates, ngarkesës së punës, urdhrave të sektorit të financës etj.

Sa i takon udhëzimeve të vecanta jodetyruese për çështje konkrete, rezulton të jenë nxjerrë gjithsej 15 udhëzimeve nga Drejtuesi, Zv/drejtuesi dhe shefat e seksioneve nga të cilat nuk rezulton që të jenë kundërshtuar nga prokurorët. Kryesisht udhëzimet janë nxjerrë në momentin e regjistrimit të procedimit penal dhe në raste të tjera gjatë hetimit të çështjes në funksion të kontrollit të ecurisë dhe përfundimit të çështjes sipas kërkesave të ligjit 97/2016.

Në zbatim të nenit 42 gërma gj, 43/ gërmat b dhe ç dhe 48 e vijues te Ligjit Nr. 97/2016 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë” është kërkuar informacion prokurorëve për 6 procedime penale, si dhe në një rast informacion në tërësi për veprat penale me të arrestuar mbi 6 muaj dhe atyre në hetim të mbartura për të gjithë prokurorët.

Në drejtim të riorganizimit të brendshëm, ju bëj me dije se është mbajtur parasysh që të ketë qëndrueshmëri të prokurorëve, të cilët bëjnë pjesë në seksionet e ngritura në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Gjatë këtij viti, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është organizuar puna në katër Seksione (pas datës 01.10.2023 është superuar seksioni i trafikeve) e më konkretisht:

1. *Seksioni i Posaçëm kundër Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve Pasurore.*
2. *Seksioni për hetimin e krimeve të shpërdorimit të detyrës, trafikeve dhe narkotikëve.*
3. *Seksioni për hetimin e Krimeve të Përgjithshme.*
4. *Seksioni për hetimin e Veprave Penale me Persona të Mitur, Ekzekutimin e*

*Vendimeve Penale te formës se prerë dhe trajtimin e materialeve dhe kërkesave të ardhura nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme.*

Lidhur me masat procedurale gjatë fazës së hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimit në Gjykatë të akuzave/çështjeve ju informoj se në analizë të treguesve të punës të evidentuara për këtë vit, nga ana ime krahas evidentimit të problematikave konkrete rast pas rasti, jam fokusuar gjithnjë e më shumë në përmirësimin e punës në drejtim të përfundimit të çështjeve duke marrë masa si më poshtë:

- Në mbledhjet e përgjithshme të prokurorëve të zhvilluara në prokurori diskutohen ngarkesat e secilit prokuror, problematikat që dalin gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjeve;
- Prokurorët janë udhëzuar që të përdorin më gjerësisht urdhrat penale dhe marrëveshjet për pranimin e fajësisë, me qëllim përfundimin e çështjeve në një kohë të shkurtër;
- Në raste të veçanta, kur është çmuar e nevojshme, janë përpiluar udhëzime me karakter jo të detyrueshëm, bazuar në nenin 43/ç dhe 48 të ligjit nr. 97 të vitit 2016 “Per organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Është kërkuar informacion lidhur me procedime penale të mbartura, apo me persona të arrestuar mbi tre muaj në hetim, bazuar në ligjin nr 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nënve 43 gërma b), c) dhe ç), nën 52/2, si dhe duke mbajtur në konsideratë detyrimin kushtetues dhe ligjor të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të kontrollit të hetimeve paraprake, pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, me synim verifikimin e ecurisë dhe përfundimit të çështjeve të mbartura, drejtimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Policisë Gjyqësore, rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së hetimit të çështjeve penale.
- Janë organizuar takime me prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, shefa seksionesh, ku janë marrë në analizë procedime penale komplekse me synim dhënien rrugë për zgjidhjen e tyre në një afat sa më të shpejt;
- Janë organizuar disa takime me oficerë të policisë gjyqësore pranë Komisarariatit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, me qëllim bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre edhe për sa i përket veprave penale sipas prioriteteve të rekomanduara;

#### **4. Mbi zbatimin e Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet në Rezolutën e Kuvendit**

Lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të tjera në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2022" miratuar më datë 14.07.2022 dhe masave/aktiviteteve sipas Planit të Veprimit të miratuar me urdhrin nr. 28, datë 08.06.2023, ku veç masave të trajtuara më sipër, lidhur me drejtimet e përcaktuara në këtë Rezolutë si më poshtë:

- I. *Të vijojë rritja e rolit aktiv të prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe të evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.*

Sa i takon rolit aktiv të prokurorit që të ushtrojnë kontroll ndaj veprimtarisë së policisë

gjyqësore, rezulton se përgjatë vitit janë zhvilluar mbledhje tematike mbi veprimtarinë e policisë gjyqësore pranë Prokurorisë, si dhe është nxjerrë udhëzimi lehtësues me nr. 31/2023 për pasqyrimin e të dhënave nga opgj-të në përmbushje të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi sistemin elektronik “SVHOPGJP. Nga ana e drejtuesit është nxjerrë udhëzim lehtësues për vlerësimin e opgj-ve, me nr. /2023. Në këtë drejtim, janë organizuar analiza ditore për të ndjekur në kohë reale numrin e veprimeve të opgj-ve për të vlerësuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së tyre, përgjegjshmërinë, respektimin e etikës, disiplinës dhe kohëzgjatjen e veprimeve hetimore të tyre të cilat në tërësinë e tyre do të shërbejnë për vlerësimin e e punës njëvjeçare. Gjatë vitit 2023 kemi dy raste të referimeve për procedim disiplinor në Komisionin e Policisë Gjyqësore.

*II. Të merren masa efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje e veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi. Të forcohen kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet, si dhe për hetimin e rasteve të dhunës në familje.*

Sa i takon rekomandimit për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje, si dhe ndaj të miturve, kemi patur bashkëpunim me institucionet e ngarkuara me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi si dhe forcimin e kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet. Për veprën penale të dhunës në familje përgjatë vitit kemi patur 82 materiale me arreste, ku një peshë kryesore e mban çështjet dhe kur vepra kryhet në prani të fëmijëve të mitur. Mbi treguesit për viktimat penale dhe për veprat penale të kryera nga të miturit, rezulton se:

Numri i përgjithshëm i çështjeve me të mitur në konfliktet me ligjin është 104 procedime penale dhe numri i autorëve të mitur në këto çështje është 61 meshkuj dhe 3 femra, 5 prej të cilëve janë ndjekur me masë sigurimi Arrest me Burg, dhe 1 me masë sigurimi “Vendosje në mbikqyrje”.

Nga procedimet penale të hetuara për këtë periudhë rezulton se në 109 prej tyre janë viktimat të veprës penale. Numri i autorëve të mitur në konflikt me ligjin (autor të veprave penale), për të cilët është zbatuar masa e shmangies nga dënimi është 22. Nga procedimet penale të regjistruara është zbatuar masa alternative e shmangies (paralajmërim me shkrim) për 20 raste, ku 2 janë dërguar me kërkesë për gjykim dhe është vendosur masë detyruese.

Në fokus të këtij objektivi prioritar edhe sipas Rezolutës së Kuvendit, e konkretisht në zbatim të Udhëzimit të përgjithshëm 17/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Udhëzimi përgjithshëm me nr. 16 datë 14.06.2021, i cili ndër të tjera rregullon disa afate për policinë gjyqësore, e cila detyrohet që brenda 24 orëve të përcjellë në prokurori materialet referuese për dhunë në familje apo vepra të tjera të dhunës ndaj grave. Gjithashtu në këtë udhëzimi është vendosur rregulli që në cdo rast të njoftimit për veprën penale të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duhet domosdoshmërisht të kryhet njoftimi i prokurorit të gatshëm me qëllim kryerjen në mënyrë të plotë dhe të shpejtë të të gjitha veprimeve hetimore. Gjithashtu, në këtë kontekst, vlen të përmendet edhe nxjerrja e urdhrit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për caktimin e koordinatorit të viktimave, i cili përveç se mbulon asistencën ndaj viktimave në këto grupe vulnerabel kryesisht të mitur dhe gra, mban dhe raporton në mënyrë periodike të dhënat statistikore për viktimat pranë Prokurorisë Përgjithshme.

Vepra penale që kanë të bëjnë me krime të kryera ndaj fëmijëve në internet sic është ajo e parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal referuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbi bazën e njoftimeve të ardhura nga “Qendra Kombëtare për fëmijë të humbur dhe të shfrytëzuar”, aktualisht në këtë prokurori janë në hetim 9 procedime penale, gjashtë prej tyre janë regjistruar gjatë vitit 2023.

- III. Lidhur me zbatimin e rekomandimit për hetimin efektiv që lidhen me vepra penale të parashikuara nga neni 183 i Kodit Penal, rezulton të kemi patur dy raste të regjistruara për këtë lloj vepra penale përgjatë vitit 2023.
- IV. Sa i takon rekomandimit për hetimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit të parashikuara nga neni 278/a të Kodit Penal, rezulton se kemi patur tre materiale të regjistruara gjatë vitit 2023, të cilat janë nën hetim.
- V. Në kuadër të rekomandimit për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në prokurori si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional nëpërmjet përdorimit të rrjetit të pikave të kontaktit në zbatim të Konventës së KiE-së për krimin kibernetik, ju bëjmë me dije se kjo prokurori, bazuar në ligjin Nr. 8888, datë 25.4.2002 “Për Ratifikimin e Konventës për Krimin në Fushën e Kibernetikës” në D. P. Policisë së Shtetit është caktuar një pikë kontakti që punon 24 orë, me bazë 7 ditë në javë me qëllim që të sigurohet dhënia e ndihmës së menjëhershme për qëllimet e hetimeve ose gjykimeve për veprat penale në lidhje me sistemet dhe të dhënat kompjuterike ose për marrjen e provave në formë elektronike për një vepër penale.

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, gjatë vitit 2023, janë referuar 50 çështje penale në fushën e krimeve kompjuterike, të tilla si “Falsifikim Kompjuterik”, “Mashttrim Kompjuterik”, “Pornografia”, etj. Në kuadër të hetimeve për këto çështje penale, nga ana jonë bazuar në nenin 191/a të Kodit të Procedurës Penale është kërkuar në Gjykatë “Detyrimi për paraqitjen e të dhënave kompjuterike”. Më pas këto vendime janë dërguar në Pikën e Kontaktit 24/7 në D. P. Policisë e cila menjëherë ka komunikuar me kompanitë e shërbimit të internetit si “Google”, “Facebook”, etj dhe ka nxjerrë të dhënat kompjuterike të kërkuara nga ana jonë, të cilat kanë qënë të vlefshme për zbulimin e autorëve të veprës penale.

Po kështu nga ana jonë në hetimin e këtyre veprave janë përdorur edhe mjete të tjera të tilla si sekuestrimi i të dhënave kompjuterike si dhe kryerja e ekzaminimeve kompjuterike nga ana e Laboratorit të Ekzaminimeve Kompjuterike, në Policinë e Shtetit

- VI. Lidhur me rekomandimin për forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, rezulton se dhënia e informacionit mbi kërkesat e ardhura nga Inspektoriati ka rezultuar të jetë e shpejtë dhe efikase. Gjithashtu në Raportin e Inspektimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me objekt” *Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, datë 17.01.2023*, në faqen 89-93 ku flitet për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ndër të tjera citohet se nga ana e drejtuesit për sa i përket informimit dhe raportimit rezulton të jetë zbatuar Udhëzimi i Përgjithshëm me nr. 12/2020.
- Gjithashtu në kuadër të inspektimit tematik ”Mbi caktimin e çështjeve në Prokurori” rezulton se nga ana jonë është përgatitur informacioni i plotë, i cili është dërguar me datë 31.03.2023 dhe jemi në pritje të raportit përfundimtar.
- Për çështje konkrete, për të vlerësuar nisjen e procedimit disiplinor ose jo, janë gjithsej 13 kërkesa të cilave ju është kthyer përgjigje në afate të shkurtra dhe gjithashtu është vendosur arshivimi në 17 raste.

-Në zbatim të kërkesës së Rezolutës për “*Marrjen dhe zbatimin e masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval-it për pastrimin e parave/luftimin e financimit e terrorizmit, bashkëpunimit me Eurojust*” është kërkuar zbatim rigoroz i udhëzimit të përgjithshëm me nr. 10/2020.

Gjithashtu është kërkuar përdorimi me efikasitet i ndihmës së prokurorit shqiptar në Eurojust. Në referim të të dhënave statistikore rezultoi që kemi përmirësuar të situatën së çështjeve të dërguara për gjykim si dhe të sekuestreimeve të kryera në përmbushje të rekomandimeve të Moneyval-it. Konkretisht kemi dy çështje për gjykim, tre sekuestro dhe tre konfiskime.

Në përmbushje të objektivit të analizës së mëparshme për rritjen e numrit të procedimeve penale në fushën e shpërdorimit të detyrës, nga të dhënat statistikore vërehet se ka një rritje të numrit të procedimeve penale nga 41 për vitin 2022 në 63 për vitin 2023 si dhe nga 18 të dënuar në 3 të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për vitin 2023.

#### **5. Mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe si kanë ndikuar në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është angazhuar dhe ka punuar në drejtim për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në lidhje me prioritetet në hetimin e veprave penale për të cilat nga Këshilli i Ministrave ka pasur rekomandime përkatëse duke unifikuar zbatimin e këtyre rekomandimeve me urdhrat dhe udhëzimet e dala nga Prokurori i Përgjithshëm. Konkretisht këto rekomandime janë:

1. *Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit*
2. *Lufta kundër korrupsionit*
3. *Lufta kundër krimit të organizuar*
4. *Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut*
5. *Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional*

Në disa prej pikave të analizës së lartpërmendur, përfshihen edhe disa prej rekomandimeve të Këshillit të Ministrave sic janë rekomandimet e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në zbatim të rekomandimit për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, janë organizuar takime, analiza dhe trajnime të përbashkëta në nivel vendor, me strukturat e Drejtorisë së Policisë, Tatimeve dhe Doganave. Për sa i përket trajnimeve në nivel vendor rezultoi të jetë organizuar trajnim sa i takon veprave penale në fushën e zgjedhjeve, ku kanë marrë pjesë dy prokurorë të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, M. Kullolli, dhe D. Pali në rolin e ekspertëve. Gjithashtu rezultoi të jetë organizuar takim me përfaqësues të Dhomës së Ndërmjetësimit më rastin e hapjes së zyrës së saj në Durrës, takime sa i takon diskutimeve mbi hartën e re gjyqësore, si dhe një sërë takimesh të tjera organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme të cilat janë zhvilluar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt diskutimin e veprave penale në fushën e pastrimit të parave, kontrabandës së naftës nga shtete për të cilat është vendosur embargo, kriminalistikën etj.

Në nenin 148 i Kushtetutës parashikon se:

1. *Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.*
2. *Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.*

Në këtë drejtim nga ana ime gjatë ushtrimit të detyrës si drejtuese janë mbajtur parasysh këto parime të rëndësishme të parashikuara në Kushtetutë, ligjin 97/2016, 96/2016 si dhe Udhëzimin me nr. 12/2020 i Prokurorit të Përgjithshëm që rregullon marrëdhënien drejtues-prokuror, me synim garantimin e pavarësisë, forcimit të integritetit, efikasitetit, efikasitetit, përgjegjshmërisë së prokurorëve dhe mbikqytjen në zbatimin e udhëzimeve si dhe respektimin e standarteve etike dhe profesionale.

Ngarkesa e madhe e punës dhe burimet e kufizuara, për shkak të shkarkimit nga KPK-ja të disa prokurorëve, karakterizojnë situatën edhe në prokurorinë e Durrësit. Prandaj, rritja e efektivitetit të punës në prokurori është prioriteti i punës time për të garantuar përmbushjen e misionit tonë të ndjekjes penale. Në këtë drejtim kemi patur mbështetjen nga Prokuroria e Përgjithshme në rritjen e numrit të opgj-ve, cka ka rritur efektivitetin në kryerjen e detyrave hetimore.

Sa I takon rekomandimit që lidhet me *“Forcimin e cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit referuar kompetencës lëndore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur sipas kompetencës, dhe rritjen e numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave”* në analizat e përbashkëta me Drejtues të Policisë së Shtetit është nxitur dhe kërkuar rritja e numrit të referimeve lidhur me këtë vepër penale.

Nga të dhënat statistikore rezulton të kemi një rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale në fushën e korrupsionit, ku konkretisht nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara është 11, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 16. Në vitin 2022 numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 3 me 9 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 13 me 21 të pandehur. Në vitin 2022 numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është 3, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 16,

Ka patur një përmirësim vitin e kaluar lidhur me referimet për veprën penale të korrupsionit për hetime proaktive, megjithëkëtë mbetet më shumë për tu bërë në drejtim të rritjes së numrit të referimeve për kryerjen me veprime proaktive të hetimit të rasteve të korrupsionit.

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve për *“Shtimin e rasteve të gjurmimit të produkteve të veprave penale /aseteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve /konfiskimeve përfshirë rastet e tjetërsimit të tyre nga persona të tretë”*, si dhe *“Vijimin e rritjes së numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim si de numrit të sekuestrimeve /konfiskimeve”*, është kërkuar zbatim rigoroz i udhëzimit të përgjithshëm me nr. 10/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm. Nga Seksioni i Posaçëm është bërë një punë e mirë për të rritur efikasitetin në drejtim të sekuestrimeve dhe konfiskimeve. Për këtë vit kemi 3 kërkesa për sekuestro pasurie dhe tre kërkesa për konfiskim, një nga të cilat në kuadër të Ligjit Antimafia. Pra kemi një rritje krahasuar me një vit më parë.

Sa I takon rekomandimit për *“Rritje e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikëve, trafiqeve dhe terrorizmit, si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale”*, nga ana jonë janë zhvilluar takime të përbashkëta me Drejtues të Drejtorisë Vendore Durrës dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për trajtimin e problematikave të hasura në hetimin e veprave penale të trafiqeve dhe narkotikëve.

Nga ana jonë i është kushtuar një vëmendje dhe fokus i posaçëm luftës kundër kultivimit të bimëve narkotike duke trajtuar me seriozitet çdo dyshim për kultivim dhe gjithashtu duke vijuar pjesëmarrjen dhe angazhimin në Task Forcën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Nga të dhënat statistikore rezultojnë të kemi një rritje të numrit të referimeve për këto kategori veprash penale nga 90 për vitin 2022 në 95 procedime për 2023 si dhe nga 53 të dënuar për vitin 2022, në 26 të dënuar për vitin 2023.

- *Problematikë mbetet volumi i madh i punës së prokurorëve, për shkak të referimeve për mbajtje të narkotikëve në doza të vogla dhe për përdorim vetiak. Policia Gjyqësore duhet të mbaje të dhëna të kartotekës kriminale, të cilat duhet t'i përdore në funksion të hetimeve duke bërë dallimin e përdoruesve nga shpërndarësit me qëllim efektivitetin e punës në këtë drejtim pasi janë raste të pasuksesshme, që në nisje të tyre.*

Nga të dhënat statistikore rezultojnë që të kemi rritje në numrin e veprave penale të trafikimit të narkotikëve. Konkretisht, në referim të të dhënave statistikore rezultojnë që për vitin 2022 të kemi 3 çështje të regjistruara nga të cilat 1 procedim është dërguar për gjykim për këtë vepër penale. Për vitin 2023 janë regjistruar 5 procedime penale për trafikim narkotikësh, nga të cilat 2 procedime janë dërguar për gjykim.

Pra edhe ky rekomandim rezultojnë të jetë përmbushur.

Në kuadër të zbatimit të rekomandimit për “*Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e e parave /luftimin e financimit të terrorizmit , të bashkëpunimit me Eurojust si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore*”, është kërkuar zbatim rigoroz i udhëzimit të përgjithshëm me nr. 10/2020 Gjithashtu është kërkuar përdorimi me efikasitet i ndihmës së prokurorit shqiptar në Eurojust. Në referim të të dhënave statistikore rezultojnë që kemi përmirësim të situatës së çështjeve të dërguara për gjykim si dhe të sekuestreimeve të kryera në përmbushje të rekomandimeve të Moneyval-it. Konkretisht kemi dy çështje për gjykim, 3 sekuestro dhe tre konfiskime. Sa i takon marrëdhëniet me Eurojust, vlen të përmendet bashkëpunimi i ngushtë mes nesh dhe prokurorit përfaqësues në disa raste.

Duhet theksuar se kemi një çështje penale në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore të regjistruar dhe të dërguar për gjykim, krahasuar me vitet e tjera kur nuk kemi patur raste të regjistruara për këtë vepër penale.

Pra dhe ky rekomandim rezultojnë të jetë përmbushur.

Lidhur me rekomandimin për “*Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetësore për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike*”, nga ana jonë është vijuar me rritjen e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese, me pjesëmarrjen në takime dhe konferenca të zhvilluara për përmbushjen e këtij rekomandimi.

Krahas sa më sipërcituar, nga ana ime janë marrë masat për zbatimin e Udhëzimit me nr. 3/2019, ndryshuar me Udhëzimin nr.2/2021 “*Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore*”. Konkretisht është nxjerrë Udhëzimi me nr. 15/2023 nxjerrë për lehtësimin e zbatimit të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë drejtim, rezultojnë të jetë organizuar trajnim sa i takon veprave penale në fushën e ve, ku kanë marrë pjesë dy prokurorë të Prokurorisë

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, M. Kullolli, dhe D. Pali në rolin e ekspertëve. Për vitin 2023 kemi 9 procedime penale të regjistruara nga të cilat dy janë pushuar ndërsa 6 procedime penale janë në hetim, dy materiale hetimore të mosfilluara.

Sa I takon zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm me nr. 8/2020 ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/2021 rezulton të jetë plotësuar regjistri I shpenzimeve proceduriale ndërsa raportimi periodik është kryer në funksion të zërit 602 nga ana e Zyrës së Financës në Prokurori.

## **6. Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është angazhuar maksimalisht, që gjatë veprimtarisë së saj të mbajë parasysh mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të drejtës kushtetuese të pronës private dhe shtetërore nga veprimtaritë kriminale dhe të kundraligjshme që kanë si qëllim cënimin e tyre.

Në këtë kuadër, është patur në fokusin e punës së prokurorëve rritja e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve të reja penale, siç janë urdhri penal, marrëveshja për pranimin e fajësisë, si dhe gjykimet e drejtpërdrejta, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin dhe rrezikshmërinë e veprës, për të ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve.

Gjithashtu është mbajtur parasysh në hetimet paraprake, në mënyrë të veçantë zbatimi i kushteve dhe kriterëve ligjore që kanë të bëjnë me masat e sigurimit personal, në funksion të respektimit të parimit të ligjshmërisë, si dhe respektimin dhe zbatimin e të drejtave të viktimave.

Nga ana e prokurorëve, pavarësisht ngarkesës në rritje, është siguruar gjithmonë pjesëmarrja në vendngjarje, për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, ose kanë pyetur vetë personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale si dhe viktimat e tyre.

Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut, është mbajtur në konsideratë edhe në rritjen e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve.

Një kujdes i veçantë në këtë aspekt është mbajtur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në kërkesat e saj për të pandehurit e mitur dhe të pandehurat femra ku në shumicën e rasteve nisur dhe nga rrezikshmëria shoqërore e tyre, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë kërkuar masa sigurimi të ndryshme nga ajo e arrestit me burg si dhe dënime alternative. Kjo në funksion të qëllimit të vetëm ligjor të riintegritimit në shoqëri të kësaj kategorie të pandehurish.

## **7. Të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe dëshmitarë**

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në procesin penal ka qenë në fokusin e punës së organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës gjatë vitit 2023. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ushtron veprimtarinë e tij Seksioni për Hetimin e veprave penale me persona të mitur, i përbërë nga katër prokurorë, ku objekt i veprimtarisë së këtij seksioni janë edhe trajtimi i kërkesave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, ekzekutimi i



vendimeve penale të formës së prerë, kërkesave në fazën e ekzekutimeve, si dhe i kërkesave të tjera të drejtpërdrejta në gjykatë.

Prokurorët e këtij seksioni, kanë trajtuar me profesionalizëm procedimet penale në hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar ose dëshmitar. Gjatë vitit 2023, ky seksion ka zbatuar me rigorozitet Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, zbatimin e cilit ka nisur në janar të vitit 2018. Ky seksion ka zbatuar me përpikmëri të gjitha kërkesat ligjore për respektimin në maksimum të të drejtave të miturve në konflikt me ligjin. Me hyrjen në fuqi të ligjit 97/2016 është caktuar edhe prokurori koordinator për të miturit, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm me nr.5 datë 26.10.2018 “*Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale*”.

Në të gjitha rastet nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është siguruar pjesëmarrja e psikologut gjatë hetimit si dhe është ruajtur sekreti i informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore lidhur me provat e mbledhura për hetimin në ngarkim të të pandehurve të mitur. Në çdo rast prokurori i seksionit për hetimin e krimit të kryer nga të miturit ka njoftuar pa vonesë prindërit ose përfaqësuesit ligjorë të tyre duke ju përmbajtur parimit më të lartë të interesit të të miturit.

Vlen të përmendet se nga seksioni për të mitur vazhdon zbatimin e aplikimit të shmangies së të miturve nga dënimi, ku treguesit do të paraqiten më poshtë në mënyrë më të detajuar.

Megjithëkëtë gjatë punës janë hasur edhe problematika që kanë të bëjnë sidomos me të miturit të cilët janë përsëritës në kryerjen e veprave penale, kanë qenë të dënuar më parë dhe në rastet e kapjes në flagrancë, gjatë kryerjes së një veprë tjetër penale është proceduar dhe me arrestimin e tyre. Në shumicën e rasteve këto arrestime janë përligjur dhe nga gjykata.

Për këtë problematikë, vazhdon të bëhet shkak mungesa e institucioneve përkatëse për trajtimin e këtyre të miturve të cilët në një farë mënyre edhe janë braktisur nga prindërit e tyre dhe si mënyrë mbijetese kanë kryerjen e veprave penale kryesisht atë të vjedhjes.

Përsa i përket hetimit të çështjeve penale me të mitur një problematikë tjetër është domosdoshmëria e krijimit të kushteve dhe ambienteve të përshtatshme për pyetjen e të miturve dhe sidomos të të miturve viktimave të veprave penale dhe të abuzuar seksualisht. Kjo është domosdoshmëri dhe kërkesë e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Konkretisht në këtë aspekt institucionit tonë i është ofruar ndihmë nga Fondacioni suedez, po për mungesë ambientesh nuk është realizuar.

Jemi në fazat e para të aplikimit të ndërmjetësimit për sa i përket atyre rasteve që mund të referohen në qendrën e ndërmjetësimit sipas parashikimeve konkrete të Kodit Penal për të Mitur;

Në gjykimin e çështjeve penale me të mitur, konstatohen raste problematike lidhur me caktimin e dënimit për të miturit për ato që janë përsëritës në kryerjen e veprës penale duke qenë se në Kodin e Drejtësisë për të mitur ka një kufizim në aplikimin e dënimit me burgim (për vepra penale që parashikojnë një dënim me burgim jo më pak se 7 vjet), ndërkohë që janë kushtet e përgjithshme ligjore sipas Kodit Penal, përsa i përket caktimit të dënimit me burgim dhe për rastin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. Prandaj në të tilla raste, llojet dhe masa e dënimit nuk kanë ndikimin e duhur në rehabilitimin dhe të riintegrimin në shoqëri të kësaj kategorie të pandehurish.

## 8. Grupet vulnerabël të pandehur dhe viktime

Veprimtaria e prokurorëve dhe policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është udhëhequr me prioritet në respektimin e të drejtave të grupeve vulnerabël (të pandehur apo viktime), duke u fokusuar kryesisht në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të dhunës në familje, dhunës apo shfrytëzimit seksual ndaj grave, personave me aftësi të kufizuara dhe abuzimeve seksuale/keqtrajtimit të të miturve.

Në fokus të këtij objekti prioritar edhe sipas Rezolutës së Kuvendit, e konkretisht në zbatim të Udhëzimit të përgjithshëm 17/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Udhëzimi përgjithshëm me nr. 16 datë 14.06.2021, i cili ndër të tjera rregullon disa afate për policinë gjyqësore, e cila detyrohet që brenda 24 orëve të përcjellë në prokurori materialet referuese për dhunë në familje apo vepra të tjera të dhunës ndaj grave. Gjithashtu në këtë udhëzimi është vendosur rregulli që në cdo rast të njoftimit për veprë penale të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duhet domosdoshmërisht të kryhet njoftimi i prokurorit të gatshëm me qëllim kryerjen në mënyrë të plotë dhe të shpejtë të të gjitha veprimeve hetimore.

Gjithashtu, në këtë kontekst, vlen të përmendet edhe nxjerrja e urdhrit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për caktimin e koordinatorit të viktimeve, i cili përvec se mbulon asistencën ndaj viktimeve në këto grupe vulnerabël kryesisht të mitur dhe gra, mban dhe raporton në mënyrë periodike të dhënat statistikore për viktimat pranë Prokurorisë Përgjithshme.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023, me qëllim kryerjen e hetimeve në afate optimale dhe efçente në procedimet penale për vepra penale të dhunës në familje si dhe duke pasur në fokus detyrimin për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të viktimeve, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë dhe Drejtuesit të Seksionit janë nxjerrë një numër i konsiderueshëm udhëzimesh për çështje penale konkrete, të cilat janë zbatuar me rigorozitet nga prokurorët përkatës.

Gjatë vitit 2023 Zyra e Ekzekutimeve dhe Seksionit të të Miturve Durrës ka pasur takime në lidhje me evidentimin e problematikave kryesisht mbi ekzekutimin e vendimeve penale, me personat që paraqiten apo jo tek Shërbimi i Provës si edhe me Komisariatit e Policisë Durrës në lidhje me ndërjegjësimin dhe trajtimin me përparësi të rasteve me të mitur qoftë autor të veprës penale por edhe viktimë. Në këto takime janë specifikuar edhe procedurat që duhet të ndiqen në trajtimin e këtyre rasteve konform Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Po ashtu ka pasur takime edhe me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Durrës duke kërkuar koordinimin e punës në rastet e paraqitjes së fëmijëve në Komisariatit e Policisë Durrës. Po ashtu jemi alternuar edhe me Zyrat përkatëse që ofrojnë Aksesin në Drejtësi në lidhje me ofrimin dhe dhënien e ndihmës juridike falas për të miturit, gratë e dhunuara, personat me aftësi të kufizuara dhe çdo grup tjetër interesi.

Nisur sa më sipër, nga të dhënat statistikore për vitin 2023, edhe pse rezulton një rritje e numrit të veprave penale të dhunës në familje, këto udhëzime janë zbatuar me prioritet nga prokurorët dhe policia gjyqësore, ku konkretisht evidentohet:

- shpejtësia në ndjekjen penale të këtyre procedimeve penale;
- vlerësimi i menjëhershëm i provave të mbledhura në momentet e para;
- prania e prokurorit dhe koordinatorit të viktimeve gjatë marrjes së të dhënave nga viktime e veprës penale;
- informimi i viktimës me të drejtat specifike të parashikuara në konventa, ligj dhe udhëzimet, specifikisht ndihma juridike falas;

-kërkimi në gjykatë nga ana e prokurorit të masave të sigurimit dhe në vazhdim të llojeve dhe masave të dënimit, duke pasur në fokus në radhë të parë sigurinë e jetës dhe shëndetit të viktimave, në vlerësim maksimal edhe të rrethanave rënduese si recidivizmin e autorit dhe pasojat e shkaktuara viktimës.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datë 07.07.2021, ka regjistruar procedimin penal Nr.1272, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i K. Penal. Me vendimin dt.29.03.2023 është urdhëruar pasqyrimi i shënimeve në regjistrimin e njoftimit të veprave penale nga vepra penale e parashikuar nga neni 99 i K. Penal në veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i K. Penal. Ky procedim penal është dërguar për gjykim në ngarkim të të pandehurit X dhe cështja është në shqyrtim gjyqësor. Në lidhje me këtë procedim ai është regjistruar fillimisht për veprën penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes” të parashikuar nga neni 99 i K. Penal dhe gjatë hetimit intensiv ka rezultuar se i pandehuri ka konsumuar elementët e frigurës së veprës penale të ‘Vrasja për shkak të mardhënieve familjare’ të parashikuar nga neni 79/c i K. Penal.

Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. 1340 dt. 02.08.2023, për veprën penale “Vrasje me dashje” parashikuar nga neni 76 dhe 25 i Kodit Penal ku viktimë e kësaj vepre penale ishte një grua, e cila ishte e pastrehë. Janë kryer menjëherë veprime të shpejta hetimore për zbulimin e autorëve dhe arrestimin e tyre, si dhe janë njoftuar familjarët e viktimës në lidhje me cështjen. Hetimet janë kryer një një kohe të shpejtë dhe dosja është nisur për gjykim.

## **9. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe zbatimi i akteve/marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, me KLSH, me ILDKPKI, etj.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2023 ka patur marrëdhënie korrekte dhe pozitive me institucionet e tjera, të cilat janë të përfshira dhe të lidhura me punën tonë. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

**Këshillin e Lartë të Prokurorisë**  
**Prokurorinë e Përgjithshme**  
**Prokurorinë e Posaçme**  
**Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës**  
**Prokurorinë e Apelit Durrës**  
**Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës**  
**Prokurorinë e Posaçme**  
**Institucione të tjera në nivel qendror dhe lokal**

**Raportet me Këshillin e lartë të Prokurorisë**, gjatë vitit 2023, është vërejtur një raport shumë korrekt, i cili konsiston në gatishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë për zbatimin e të gjithë detyrimeve ligjore përkatëse me përpikmëri. Duke qenë se këtë vit nga ana e KLP-së ka filluar zbatimin i vlerësimit profesional të prokurorëve, dhe në këtë kuadër janë kërkuar të dhënat e punës së prokurorëve, konstatohet që në regjistrat aktualë elektronike nuk janë pasqyruar të gjithë treguesit e punës së prokurorëve sipas modelit të të dhënave që është miratuar nga ana e KLP-së. Për këtë arsye, nga ana jonë janë hasur vështirësi në nxjerrjen në kohë të këtyre të dhënave që ndodhen në dosjet e arshivuara dhe në regjistrat fizikë, ku për këtë qëllim, në kushte jonormale, janë angazhuar vetë prokurorët që janë në vlerësim, përpos ngarkesës së punës që ata kanë në rritje. Pavarësisht kësaj vështirësie, Prokuroria e Durrësit është pararojë sa i takon plotësimin e të dhënave në mënyrë të shpejtë dhe të saktë megjithë problemet që evidentohen sa i takon përcaktimit të rendimentit të prokurorit dhe prokurorëve.

**Raportet me Prokurorinë e Përgjithshme**, gjatë vitit 2023 është vërejtur një raport shumë i ngushtë bashkëpunimi, i cili konsiston në gatishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë nga të gjitha drejtoritë pranë Prokurorisë së Përgjithshme për zbatimin e të gjithë detyrimeve ligjore me përpikmëri.

Veçanërisht nga ana e prokurorëve të ekzekutimeve janë mbajtur raporte bashkëpunimi të vazhdueshme, ku mbetet për t'u vlerësuar gatishmëria e tyre, në trajtimin e kërkesave për ekstradim apo ndihmë juridike nga autoritet e huaja.

Gjithashtu nga ana e sektorëve të ndryshëm brenda institucionit tonë (si Zyra e regjistrimit-Arkiva-Kryesekretaria), është për t'u vlerësuar gatishmëria dhe disponibiliteti ndaj Drejtorisë së Koordinimit në Prokurorinë e Përgjithshme, për çdo kërkesë të karakterit të ngutshëm, të cilave u janë përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të përcaktuara.

### **Raportet me Prokurorinë e Posaçme**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka mbajtur raporte bashkëpunimi të ndërsjellta me Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2023, ku vlen të përmenden rastet që lidhen me hetimin e veprave penale në fushën e trafikut të drogës, krimet të organizuar si dhe hetimet pasurore. Për vitin 2023, nga ana e institucionit tonë janë dërguar pranë Prokurorisë së Posaçme, për moskompetencë lëndore, 5 procedime penale, për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 283, 287, 257/a dhe 245/1, nga të cilat janë pranuar nga ana e tyre 4. Gjithashtu nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme dhe në disa raste me prokurorët e çështjeve, me qëllim kryerjen me efikasitet të hetimeve të filluara nga ana jonë, por që më pas kanë kaluar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme, kryesisht për rastet e trafikut të drogës nëpërmjet portit të Durrësit .

**Raportet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës**, gjatë vitit 2023 kanë qenë korrekte dhe ligjore duke u bazuar në korrektesën e ndërsjelltë dhe reciproke.

Edhe pse me ndryshimet e të Kodit të Procedurës Penale, është dyfishuar koha që prokurori merr pjesë në gjykim, duke sjellë si rrjedhojë edhe ngarkesë në menaxhimin e dosjeve në fazën e hetimit, përgjithësisht prokurorët kanë qenë korrektë në pjesëmarrjet në gjykim.

Ka patur edhe raste të mungesave të prokurorëve, të cilat kanë ardhur nga shkaqe objektive, si shkarkimi i prokurorëve dhe koha e nevojshme për shortimin dhe shpërndarjen e dosjeve që ata kanë pasur në ngarkim; pjesëmarrja në trajnime, përplasjet me orare të tjera gjyqësore (per shkak të mungesës së sallave) apo kryerje e veprimeve hetimore me përparësi.

Ndërkohë nga ana tjetër, përgjatë vitit 2023, konstatohet që nga një pjesë e gjyqtarëve janë caktuar seanca gjyqësore tej afateve ligjore të parashikuara në ligj, duke sjellë problematika veçanërisht në çështjet me të arrestuar dhe me gjykim të zakonshëm.

Rezulton se ka patur raste të kthimit të dosjeve për plotësim si të atyre të dërguara për gjykim ashtu dhe për pushim.

Në zbatim të dispozitave procedurale penale nga ana jonë është analizuar çdo rast, duke kryer veprimet hetimore kur vendimi i gjykatës ka qenë i bazuar, si dhe është ushtruar ankimi ndaj vendimeve gjyqësore në rastet kur në vlerësimin e prokurorit vendimet kanë qenë të pambështetura në ligj.

Ka patur bashkëpunim dhe mirëkuptim të plotë me Zv/Kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në rastet e trajtimit dhe përmirësimit të problematikave të veçanta që janë shfaqur gjatë punës.

Trajtimin më evident të të dhënave që kanë rezultuar në kërkesat drejtuar gjykatës do ta trajtojmë në materialin vijues.

**Raportet me Prokurorinë e Apelit Durrës**, vazhdojnë të jenë raporte reciproke dhe të ndërsjellta duke mbajtur kontakte të vazhdueshme në funksion të përfaqësimit të akuzës lidhur me çështjet penale të ankimuara nga Prokurorët pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Rezulton se Prokurorët pranë Gjykatës së Apelit Durrës në shumicën e rasteve kanë përkrahur ankimet e bëra nga ana e Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës

së Parë Durrës si në Gjykatën e Apelit Durrës ashtu dhe duke ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Po kështu vetëm në raste të veçanta rezulton se në disa raste nga prokurorët e Apelit nuk është bërë përkrahja e ankimit të ushtruar nga Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duke hequr dorë nga ankimi.

**Raporti me Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë Vendore e Policisë Durrës**, gjatë vitit 2023 përveç respektimit me rigorozitet të detyrimeve ligjore dhe në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit është synuar krijimi i një raporti të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit që veprojnë në rrethin e Durrësit, si Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut, etj.

Vlen të përmendet që në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, edhe për vitin 2023, nga ana e institucionit tonë vazhdon të respektohet me korrektësi Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1460, dt. 30.09.2020, si dhe udhëzimit nr.15 dt.30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe Urdhrit nr. 942, dt.26.11.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Madje për këtë vit, konstatohet një përmirësim në cilësi dhe në shpejtësi të raportimeve të kryera nga ana e policisë gjyqësore të DPQ, si rezultat i kërkesave të vazhdueshme nga ana jonë për respektim të këtij memorandumi, që ka sjellë si rrjedhojë edhe uljen e vendimeve të mosfillimeve dhe ngarkesës së prokurorëve.

Pavarësisht sa më sipër gjatë këtij viti janë evidentuar edhe disa problematika, të cilat janë trajtuar dhe orientuar drejt zgjidhjes së tyre si ato që lidhen me:

- kryerjen në kohë të veprimeve të para dhe të papërsëritshme, referimi i materialit hetimor brenda afateve procedurale
- dorëzimin e dosjeve tek prokurori sipas afateve të përcaktuara në urdhrat për kryerjen e veprimeve hetimore,
- dorëzimin brenda afatit procedural të akteve që përmbajnë kontrole, sekuestrime etj., ku theksoj që kjo problematikë vazhdon prej disa vitesh.
- lëvizja e shpeshtë e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në detyra të tjera apo sektorë të tjerë duke sjellë si pasojë zvarritjen e hetimeve për shkak të dorëzimit të dosjeve të deleguara;

Raporti me institucionet e tjera qëndrore si ILD, KLSH, ILDKPKI dhe organet e qeverisjes vendore, etj vazhdon të jetë korrekt, institucional dhe i ndërsjelltë.

## **10. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe/ose nëpërmjet prokurorit ndërlidhës shqiptar në EUROJUST**

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme si hallka kryesore lidhëse për marrëdhëniet ndërkombëtare të Prokurorisë. Në këtë kuadër ka ekzistuar një bashkëpunim i mirë me shtetet e huaja si për ekzekutimin e letërporosive të ardhura nga jashtë, por edhe të atyre të përcjella nga ana jonë.

Rol i veçantë i është kushtuar ekstradimeve, urdhrave të kërkimit ndërkombëtar, duke patur parasysh respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të drejtave të njeriut dhe parimin e reciprocitetit.

Vlen për t'u përmendur gatishmëria jonë dhe përmbushja në kohë të shpejtë e kërkesave për ndihme juridike.

Gjithashtu në këtë kuadër, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është realizuar edhe një takim me prokurorë spanjolle, në nivel drejtues të ekipit EU4FOCAL, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian që synon të mbështesë prokurorët shqiptarë dhe agjencitë ligjzbatuese në trajtimin e krimit përmes hetimit penal dhe financiar, si dhe luftën

kundër pastrimit të parave, me qëllim përmirësimin e nevojave të njësisë të specializuara kundër pastrimit të parave, krimeve financiare dhe hetimit financiar.

## **11. Të dhëna për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre**

-Gjatë vitit 2023, janë kryer trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare, nga prokurorët dhe OPGJ-të si më poshtë të renditura të cilat janë kryer:

### **Trajnime kombëtare**

Burimet e hapura. Fillimi kryesisht i procedimit penal.

-Shfrytëzimi seksual online I të miturve dhe metodat e hetimit.

-Ndërtimi I paligjshëm.

-Lirimi me kusht. Kushtet e lejimit, kriteret ligjore që duhen përmbushur. Dënimi me burgim të përjetshëm dhe përlllogaritjet e kohës së vuajtjes së dënimit. Periudha e sigurisë dhe lirimi me kusht. Përsëritja në krim, sjellja e të dënuarit në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe marrëdhënies autorë-viktimë si elemente thelbësore të raportit të vlerësimit të shërbimit të provës. Konkluzioni rreth “arritjes së qëllimit të dënimit” dhe roli i raportit të vlerësimit në procesin penal. Dallimet në zbatimin e Institutit të "Lirimit me kusht" ndaj të dënuarit madhor dhe të miturit në konflikt me ligjin. Zëvendësimi i pjesës së pakryer të dënimit si një risi në legjislacionin penal të drejtësisë për të mitur.

-Ekstradimi. Rëndësia e marrëveshjes ndërshtetërore për lejimin e ekstradimit jashtë të shtetasve shqiptarë. Autoriteti i ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar përmbajtjen e kërkesës për ekstradim. Ne bis in idem. Njohja e vendimit penal të huaj dhe fillimi i hetimeve të brendshme për shkak të njoftimit të kërkesës për ekstradim, nenet 6; 7 dhe 7/a të Kodit Penal.

-Gjykimi i shkurtuar dhe gjykimi me marrëveshje. Gjetjet/paqartësitë, interpretimet diverse të zbatimit në praktikën gjyqësore, kriteret ligjore të kërkimit dhe zhvillimit të procedurës së këtyre gjykimeve të posaçme, pas ndryshimeve të KPP-së me ligjin nr. 41/2021. Aplikimi i tyre tek i pandehuri dhe i mituri në konflikt me ligjin. Nevoja për trajtim, diskutim dhe interpretim të dispozitave të KPP-së që disiplinojnë garancitë e secilit në procesin penal.

-Roli Subsidiar i gjyqtarit në gjykimin e zakonshëm në pretendimeve me natyrë kushtetuese. Roli I gjyqtarit në gjykimin e zakonshëm lidhur me interpretim pajtues të ligjeve.

- Krimi kibernetik. Aktet me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike
- Masat mjekësore në procesin penal (neni 46 i K.Penal). Problemet procedurale në lidhje me figurën e re të GjSP dhe caktimin e dënimit
- Përgjimet procedurale dhe përgjimet parandaluese. Trajtimi procedural i të parave dhe vlera e informacionit që përfitohet nga të dytat në procesin penal
- Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria, si element të anës subjektive të figures së veprës penale.
- Tema mbi trafikimin e qenieve njerësore;
- Tema mbi pastrimin e parave;
- Tema mbi fillimin kryesisht të ceshtjeve;
- Tema mbi përgjimet;
- Tema mbi trafikimin e lendeve *narkotike*

- trajnim me temë: “Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në lidhje me sulmet kopjuterike”, Turqi.
- “Risitë e gjykimit penal në Gjykatën e Lartë. Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale. Ridimensionimi i gjykimit në dhomë këshillimi. Veprimet përgatitore të gjykatë. Gjyqtari relator dhe trupa. Dhoma e këshillimit, procedura e gjykimit dhe vendimmarrja”
- “Mjete të posaçme të hetimit. Pasqyrë e kornizave ligjore aktuale të mjeteve të posaçme të hetimit. Analize e rasteve të zgjedhura. Instrumentet ndërkombëtarë që parashikojnë teknikat e posaçme të hetimit. Jurisprudenca e GJEDNJ”
- “Kërkesat e Prokurorisë për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe pasojat e mosrespektimit të tyre. Kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake.
- “Lidhja shkakësore në të drejtën penale. Problemi i lidhjes shkakësore në rastin e provës shkencore. Trajtimi doktrinar dhe sipas praktikës gjyqësore”
- Përgjimet procedurale dhe përgjimet parandaluese. Trajtimi procedural i të parave dhe vlera e informacionit që përftohet nga të dytat në procesin penal.
- "Rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale (mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, zbatimi i urdhrin, ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës – doktrinë dhe praktikë gjyqësore vendase dhe e huaj".
- Hierarkia e Prokurorisë dhe marrëdhënia procedurale ndërmjet prokurorit ndihmës dhe titullarit të prokurorisë
- tema “UNODC Training Course On Systems Analysis And Disruption Planning - Drug Trafficking, Migrant Smuggling, Human Trafficking And Modern Slavery”, organizuar nga UNODC;
- tema “Pastrimi i parave”, organizuar nga Shkolla e Magjistratures ne bashkepunim me GIZ;
- tema “Provat elektronike per hetimin e krimit kibernetik”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në hage;
- Tema “Veprat penale te shtuara apo ndryshuara ne Kodin Penal në lidhje me Dhunën në familje”, oranizuar nga Shkolla e Magjistrurës;
- “Mjete të posaçme të hetimit. Pasqyrë e kornizave ligjore aktuale të mjeteve të posaçme të hetimit. Analize e rasteve të zgjedhura. Instrumentet ndërkombëtarë që parashikojnë teknikat e posaçme të hetimit. Jurisprudenca e GJEDNJ”
- Shkolla e Magjistratures nje seminar online me teme: “ECtHR jurisprudence in the matters of confiscation of property acquired by criminal activity” i cili zhvillohet ditën e neserme Online në Platformen Zoom ne oren 14:30- 16:30.
- trajnimin Keshilli i Evropes ne bashkepunim me Shkollen e Magjistratures me temë “Hetimet financiare dhe perdorimi i mjeteve te inteligjences me burim te hapur”.
- Keshilli I Evropes, aktivitet për: “Kursin e Trajnimit personal mbi Investigimet Financiare, Monedhat Virtuale dhe Darknet”.Hotel Piazza, Tiranë.
- EU4FOCAL do te zhvilloje trajnimin mbi "Pastrimin e parave dhe rikuperimin e asetete", ne Tiranë.
- OSBE "Masat ndaj trafikimit të personave nëpërmjet teknologjisë".
- EU4FOCAL trajnimin mbi "Pastrimin e parave Hetimet Financiare dhe Ndhma e Ndersjelle Juridike", në Tiranë.
- temë “E drejta gjyqësore; Precedenti; Roli i vendimeve gjyqësore, jurisprudencës, në kuptimin e gjerë dhe të doktrinës në formësimin e së drejtës. Gjyqtari si ligjbërës në shekullin XXI”, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë.
- “Gjykata e Lartë si gjykatë që njëson, zhvillon dhe ndryshon praktikën gjyqësore. Risitë e procedurës së gjykimit njëses, sipas ndryshime të legjislacionit procedural. Praktika gjyqësore dhe njësimi - dy shkaqe të ndryshme për pranueshmërinë e rekursit. Efektet juridike të vendimeve që vendosin praktikën gjyqësore, si dhe

raporti i tyre me vendimet njësuere. Roli i gjyqtarit të çdo niveli në funksion të njësimi dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore”, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë.

- "Seanca paraprake në tërësinë e saj. Praktika gjyqësore e deritanishme. Neni 332/d, vendimi i seancës paraprake dhe konsekuencat e tij për vazhdimësinë e procedimit të filluar nga prokurori."
- date 22 Maj 2023 me teme: "Urdhri European i ndalimit" dhe "arrestit ndërkombëtar" si instrumente të rëndësishme për përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së.
- teme "te drejtat e te denuarve qe vuajne denimin ne IEVP, praktika gjyqësore per uljen e denimit sipas nenit 75 te Ligjit 81/2020".
- date 10 Mars 2023 me teme:
- "Roli i prokurorit në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Gjykata kompetente e trajtimit të kërkesave përgjatë ekzekutimit të vendimit. Jurisprudenca vendase dhe GJEDNJ-së, konstatimet dhe interpretimet lidhur me kërkesat apo të drejtat themelore të pretenduara të cenuara nga të dënuarit në fazën e ekzekutimit të vendimit."
- Regional Ëorkshop on Cooperation and Information Sharing Betëeen Financial Investigations and Cybercrime taking place on 10-12 October 2023, organised jointly by the iPROCEEDS-2 and the CyberEast projects;
- Pastrimin e Parave dhe Financimit të Terrorizmit, 11-15 Shtator, 2023, USAID;
- E-evidence and data protection, 22, 29 shtator dhe 6 tetor, organizuar nga Euro4cal;

### **Trajnime ndërkombëtare:**

#### **23-27 Tetor 2023**

Trajnimi me temë: "Digital Skills for Law Enforcement Advancement", organizuar nga CEPOL, EUROPOL, financuar nga Unionin Europian, zhvilluar në Bukuresht, Rumani.

#### **22-24 Nëntor 2023**

Vizitë studimore në Romë, Itali, organizuar nga Eu4Focal dhe FIIAPP në institucionet kryesore të lidhura më Krimin e Organizuar, Hetimin financiar dhe Pastrimin e Parave.

#### **10-12 Tetor**

Tema "Ëorkshop Rajonal mbi bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis hetimeve financiare dhe krimin kibernetik", Antalya, Turqi

#### **21 – 23 shkurt 2023** Shkup, Maqedonia e Veriut

Programi i PROCEEDS-2 i Keshillit të Europës: Programi i certifikimit të aftësive të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë, që do të zhvillohet në Shkup, Maqedonia e Veriut, më

#### **6-8 qershor 2023**, në Pragë, Republika Çeke

Programi I PROCEEDS-2 I Keshillit të Europës, aktivitetet trajnues dhe ëorsho, në bashkëpunim me 2023 ISS Ëorld Europe, që do të zhvillohet në datat 6-8 Qershor 2023, në Prage, Republikën Çeke, në Clarion Congress Hotel. ISS Ëorld Europe synon të mbledhë ekspertë të industrisë së Zbatimit të Ligjit, Inteligjencës, Sigurisë Kombëtare, Krimin Financiar dhe Telekomit përgjegjës për hetimin e krimin kibernetik, mbikëqyrjen elektronike dhe mbledhjen e inteligjencës.

#### **21 – 23 maj** në Amadria Park Hotel Jure në Shibenik, Kroaci



Zyra jonë e DD-së ICHIP në Ambasadën e SHBA-së në Zagreb samiti I “Samiti i Krimit Kibernetik të Evropës Juglindore” i cili do të mbahet nga 21 – 23 maj në Amadria Park Hotel Jure në Shibenik, Kroaci.

### Bukuresht, 11 – 12 dhjetor 2023

Programi I PROCEEDS-2 I Keshillit te Europes, aktiviteti I “Komiteti i Konventës për Krimet Kibernetike (T-CY) T-CY 29 Raport mbi Plenaren e 29-të të Komitetit të Konventës për Krimet Kibernetike Bukuresht.

## 12. Problematikat e hasura

Gjatë vitit 2023 janë vërejtur problematika, ku disa rezultojnë që të jenë nga vitet e tjera, ndërsa disa kanë rezultuar rishtazi për këtë vit, si më poshtë:

- Gjatë vitit 2023 është vërejtur si problematikë, cilësia e ulët e kallëzimeve dhe referimeve për veprat penale në fushën e pastrimit të parave dhe krimit ekonomik në përgjithësi.
- Evidentohet një numër i ulët referimi i veprave penale nga ana e D.R.Tatimeve, ndërkohë ato që janë referuar përgjithësisht rezultojnë të jenë të bazuara në ligj dhe një numër i konsiderueshëm prej tyre janë dërguar për gjykim.
- Referimet përse i përket veprave penale në fushën e korrupsionit lidhen vetëm me rastet e flagrancës, ku subjektet janë shtetas ndërkohë që mungojnë rastet e hetimeve proaktive për nëpunës publik apo zyrtarë të administratës.
- Problematikë mbetet volumi i madh i punës së prokurorëve, për shkak të referimeve për mbajtje të narkotikëve në doza të vogla dhe për perdorimi vetiak. Policia Gjyqësore duhet të mbaje të dhëna të kartotekes kriminale, të cilat duhet t'i perdore në funksion të hetimeve duke bërë dallimin e perdoresve nga shpërndaesit me qëllim efektivitetin e punës në këtë drejtim pasi janë raste të pasuksesshme, që në nisje të tyre.
- Në rastet e hetimeve të trafikut të narkotikëve nëpërmjet portit të Durrësit, është i domosdoshëm ndryshimi i menaxhimit të informacionit paraprak nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore, me qëllim përfshirjen në kohën e duhur të prokurorit në funksion të kryerjes së hetimeve proaktive për kapjen e organizatorëve, financuesve të përfshirë në këtë veprimtari kriminale dhe përfundimin me sukses të këtyre e çështjeve.
- Kapërcimi i afateve në hetimin e veprave penale si dhe cilësia e hetimit si në përpilimin e akteve ashtu dhe në mbledhjen e provave nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Vonesa në vendimmarrjen e prokurorëve ku shkak ka qenë dhe mosbërja në kohë e akteve të ekspertimit nga ana e Policisë Shkencore dhe ekspertëve të fushave të ndryshme, gjë e cila ka çuar në zvarritjen e afateve të hetimit përtej përcaktimeve ligjore.
- Cilësi jo mirë e përpilimit të akteve procedurale nga Policia Gjyqësore si e seksionit të Prokurorisë ashtu dhe të shërbimeve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Durrës, si në referimin jo të saktë të veprës penale, marrjes së provave, gjeneraliteteve të subjekteve, veprime të cilat kanë sjellë cilësi të dobët të hetimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal duke e vendosur kështu prokurorin në vështirësi në zgjidhjen në kohë të çështjes penale si dhe të kualifikimit të drejtë të veprës penale.

- Mosnjoftimi i prokurorit për ngjarjet e ndodhura, kryesisht nga policia gjyqësore e Seksionit të qarkullimit rrugor, sekuestrimi i mjeteve si prova materiale, në kundërshtim me ligjin, për veprën penale të parashikuar nga neni 291 si dhe referimi tej afateve procedurale të materialeve hetimore për këto raste.
- Mosdërgimi në kohë i mostrave të urinës për kryerjen e ekspertimeve në veprat penale të parashikuara nga neni 291 i Kodit Penal.

## II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë

### 1. Volumi i punës në hetim

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2023 ka trajtuar në total **6844** materiale hetimore, ndërsa në vitin 2022 janë trajtuar **6074** materiale hetimore, që do të thotë se kemi një rritje me 12.67%, ku gjatë trajtimit të këtyre materialeve është konkluduar dhe më pas është vendosur regjistrimi i procedimeve penale për **2687** procedime, në krahasim me vitin 2022 ku janë regjistruar **2290** procedime. Konstatohet se kemi rritje në masën 17.33% të regjistrimeve për procedimet penale krahasuar me vitin 2022.

Në vitin 2023 është vendosur mosfillimi për **1992** materiale kallëzuese, ndërsa për vitin 2022 janë mosfilluar **1806** materiale kallëzuese. Krahasuar me vitin 2022 rezulton se kemi një rritje prej 10.29% të materialeve hetimore për të cilat trupa e prokurorëve ka vendosur mosfillimin e procedimeve penale.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2023 ka ndjekur në hetim **4848** procedime penale përfshirë dhe ato të mbartura nga viti 2022 dhe **4** procedime penale ushtarake.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2023 në hetimet paraprake ka ndjekur **4852** procedime penale, me **1969** të pandehur, nga të cilët **359** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”. Nga këto, janë regjistruar **2687** procedime penale të reja, me **1211** të pandehur, prej të cilëve **263** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Gjatë vitit **2023** janë regjistruar **48** Procedime Penale të ardhura me transferim, me 14 persona nën hetim dhe **3** të pandehur. Në krahasim me vitin **2022**, ku janë regjistruar procedime penale të ardhura me transferim për **23** materiale, me **5** persona nën hetim dhe **1** të pandehur me **1** person me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Në vitin 2023 janë rifilluar **41** procedime penale me **1** të pandehur, në krahasim me vitin 2022 ku janë rifilluar **16** procedime penale, me **4** të pandehur.

Në vitin 2023 janë përfunduar hetimet për **2545** procedime penale, me **1453** të pandehur me **227** persona të arrestuar, ndërsa për vitin 2022 ky numër procedimesh të përfunduara hetimet është **2508**, me **1443** të pandehur, nga të cilët **260** të arrestuar, që zënë **52.45%** të procedimeve penale të ndjekura ose **1.47%** procedime penale të përfunduara më shumë se në vitin 2022.


Janë mbartur për vitin 2023 në fazën e hetimeve paraprake **2076** procedime penale (këtu përfshihen 2 procedime penale ushtarake), me 546 të pandehur dhe 194 persona nën hetim, prej të cilëve **96** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”, pra rreth **42.78%** e numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2023.

Janë mbartur në hetim për vitin **2023**, **2307** procedime penale (këtu përfshihen 2 procedime penale ushtarake), me **132** persona me masë sigurimi “Arrest në burg” dhe **516** persona në hetim, krahasuar me vitin 2022 kemi një rritje prej **47.54%**.

Më poshtë, në tabelë paraqitja krahasuese e viteve 2021, 2022, 2023 evidenton treguesit e procedimeve penale të ndjekura, përfshi edhe procedimet penale të mbartura nga viti 2022, të regjistruara, të ardhura me transferim dhe të rifilluara në vitin 2023.

Vitet	Proc.Mbartura	Proc.Rregjistruara	Proc.Rifilluara	Proc. Ardhura me Transf.	Proc. Ndjekje Penale
-------	---------------	--------------------	-----------------	--------------------------	----------------------


<b>2021</b>	1752	2484	17	35	4288
<b>2022</b>	1939	2290	16	23	4268
<b>2023</b>	2076	2687	41	48	4852



Evidentohet tendenca në rritje e numrit të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2022.

## 2. Çështje të përfaqësuara në gjykatë


Gjatë vitit 2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është ngritur akuza dhe dërguar për gjykim në emër të shtetit shqiptar për **1043** procedime penale, një rritje prej **5.88%** në krahasim me vitin 2022, ku janë dërguar për gjykim **985** procedime penale, me **1289** të pandehur me **223** të arrestuar, përkundrejt 1150 të pandehurve me 245 të arrestuar në vitin 2022, një rritje prej 12.08% në krahasim me vitin 2022. Këto të dhëna paraqiten grafikisht në grafikun e mëposhtëm:



### 3. Treguesit kryesor të punës së prokurorisë

Më poshtë tabela evidenton treguesit e procedimeve penale dhe të pandehurve sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake, krahasuar me vitet 2022-2023.

	Gjyqit		Pushuara		Pezulluara		Transferuara		Përfunduara	
	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur + Persona nën hetim	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur
2021	986	1254	458	193	858	0	47	27	2349	1474
2022	985	1150	529	251	952	2	42	40	2508	1443
2023	1043	1289	451	134	989	0	62	30	2545	1453



Sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezultojnë kjo gjendje:

#### 3.1 Çështje të dërguara për gjykim

Krahasuar me vitin 2022 për vitin 2023 konstatohet rritje në masën **5.88%** të procedimeve dhe **12.08%** të pandehurve të dërguar për gjykim. Përkatësisht për vitin 2023 janë dërguar për gjykim **1043** procedime penale, ndërsa për vitin 2022 janë dërguar **985** procedime penale.

#### 3.2 Çështje të pushuara

Janë pushuar **451** procedime penale me **134** persona nën hetim që zënë **17.72%** të procedimeve penale të përfunduara. Në krahasim me vitin 2022, ku janë pushuar **529** çështje penale, me **251** persona nën hetim (1 person të arrestuar) vërehet një ulje prej **14.74%**.

Në këtë grup procedimesh, **9** prej këtyre procedimeve penale janë pushuar për mungesë fakti, **21** për mungesë prove dhe **421** për shkaqe të tjera të parashikuara nga K.Pr.Penale.

Nga këto procedime të pushuara, numrin më të madh të kërkesës për pushim e zë neni 248 i K. Penal me **52** pushime për shkaqe të tjera.

Neni 89 i K. Penal është një vepër tjetër, i cili zë një vend të konsiderueshëm në çështjet e pushuara, ku **14** prej tyre janë pushuar kryesisht për shkak të heqjes dorë nga ankimi. Gjithashtu, në lidhje me nenin 291 të K. Penal, kemi **37** procedime penale, për të cilat është marrë vendimi i pushimit, për arsye sepse rezultati i aktit të ekspertimit mjeko-ligjor (të marrjes së mostrës në gjak) ka qenë brenda normave të lejuara.

Një vepër penale tjetër, e cila nuk mund të lihet jashtë vëmendjes së analizës, është edhe neni 290 i K. Penal, ku **50** procedime të regjistruara për këtë vepër janë pushuar për shkak të rezulttit të aktit të ekspertimit autoteknik, sipas të cilit personi përgjegjës për aksidentin ka rezultuar pa shkelje.

Për nenin 275 të K. Penal kemi marrë **7** vendime për pushim, në pjesën më të madhe të tyre për shkak të heqjes dorë nga ankimi.

Në lidhje me nenin 199/a të K. Penal, janë marrë **25** vendime apo kërkesa për pushim nga ana e prokurorëve, për shkaqe të ndryshme.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë marrë **15** vendime për pushimin e çështjes, në lidhje me nenin 186 të K. Penal, për arsye të mungesës së faktit dhe shkaqe të tjera sipas vlerësimit. Ndërsa nga totali i regjistrimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i K. Penal, janë marrë **21** vendime për pushim nga ana e Prokurorëve.

Si rezultat i punës së përbashkët të prokurorisë me strukturat e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Durrës janë rifilluar hetimet për **41** procedime të pezulluara, me 1 persona të pandehur si rezultat i zbulimit të autorit apo të dhënave të tjera të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve.

Po ashtu rezulton se për vitin 2023 prokurorët kanë paraqitur në gjykatë kërkesë për pushimin e procedimit penal, për **530** procedime penale, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

### **3.3 Çështje penale të pezulluara**

Pezullimi i hetimeve është vendosur për **989** procedime penale, që zënë **38.86%** të procedimeve penale të përfunduara dhe krahasuar me vitin 2022 kemi një rritje me **3.88%** ku janë pezulluar **952** procedime penale. Të ndarë sipas shkaqeve ligjore për të cilët është vendosur pezullimi gjendja paraqitet:

Numrin më të madh të çështjeve penale për të cilat është marrë vendimi për pezullim e zë neni 134 i K. Penal, me **778** procedime të pezulluara. Gjithashtu, për nenin 141/a të K. Penal, janë marrë **7** vendime për pezullim për moszbulim autori ose në pritje të letërporosisë me autoritetet e huaja.

Në lidhje me nenin 150 të K. Penal kemi **20** çështje të pezulluara, ndërsa për nenin 151 të K. Penal janë marrë **25** vendime për pezullim, pasi nga akti i ekspertimit piroteknik zjarrvënia është e qëllimshme, por nuk bëhet i mundur identifikimi i autorit të kryerjes së veprës penale.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 190 të K. Penal, është marrë **1** vendim për pezullimin e çështjes.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 273 të K. Penal, janë marrë **11** vendime për pezullim.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 278 të K. Penal, janë marrë **9** vendime për pezullim, ndërsa për nenin 283 të K. Penal janë pezulluar **11** çështje penale.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K. Penal është pezulluar **1** çështje penale.

### **3.4 Çështje penale të transferuara**

Për vitin 2023 janë transferuar **62** procedime penale, ku krahasuar me vitin 2022 kemi një rritje me 47.61% pasi numri i tyre është **42**. Për sa i përket personave në hetim kemi një ulje prej 25%, ku në vitin 2023 janë transferuar çështje penale me 30 persona nën hetim, krahasuar me 40 persona nën hetim të çështjeve të transferuara të vitit 2022.

Me zgjatje afati janë ndjekur **121** procedime, me **166** të pandehur dhe 30 persona me masë sigurimi “Arrest në burg”, që zënë rreth **4.75%** të procedimeve penale të hetuara, krahasuar kjo me një vit më parë kemi një ulje prej 30.85%. Ndërsa për vitin 2022 janë ndjekur 175 procedime penale me zgjatje, me 252 të pandehur me 55 persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

### 3.5 Mosfillimet

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit/kallëzimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte të ndryshme fizike dhe juridike.

Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementet e veprës penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës ka pësuar rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar, pasi rezulton se për vitin 2022 është vendosur mosfillim për **1806** materiale, ndërsa në vitin 2023 është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit për **1992** kallëzime apo referime të veprës penale në Prokurori për “Rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit”, nenet 290 e 291 të K. Pr. Penale. Nga këto kallëzime të përfunduara, **65** prej tyre janë materiale verifikuese të mbartura nga viti 2021 dhe **1927** materiale verifikuese të regjistruara në vitin 2023. Në shumë raste për të cilat nuk ka patur elementë të ndonjë veprë penale, prokurorët kanë vendosur regjistrimin e procedimit penal, për shkak të respektimit të afatit 15-ditor brenda të cilit është e pamundur të administrohen aktet e ekspertimit për vepra të tilla, si “Shkaktim vetëvrasje”, neni 99 i Kodit Penal, rastet e përdorimit me ngjashmëri të pasaportave, neni 189 i Kodit Penal, por edhe vepra penale të tjera si ato të parashikuara nga nenet 290, 90, etj. që kanë qenë të qarta për mënyrën e përfundimit të tyre. Krahasuar me vitin 2022 kemi një rritje me **10.29%**.

Në lidhje me çështjet e përfunduara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykata e Apelit Durrës janë prishur **5** vendime mosfillimi të Prokurorëve. Të gjitha këto procedime penale janë në hetim.

### Veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak

Në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak për vitin 2023 janë regjistruar 2 procedime penal, një prej të cilave është dërguar për gjykim dhe një është nën hetim.

## 4. Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale


Bazuar në të dhënat e regjistrimit të njoftimeve/kallëzimeve të veprave penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezulton se në vitin 2023 janë **filluar kryesisht 4** procedime penale nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

**Kallëzime nga nëpunësit publikë:** Në vitin 2023 rezulton të jenë 104 kallëzime.

**Kallëzime nga IMT (Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit):** Në vitin 2023 rezulton të jenë 3 kallëzime.

**Kallëzime nga shtetasit:** Në vitin 2023 rezultojnë 221 kallëzime të bëra nga shtetasit.

**Gjithashtu**, theksojmë se gjatë vitit 2022 janë marrë 4970 referime nga Policia e Shtetit , 172 referime nga Polici të Tjera dhe nga **Policia Ushtarake** kemi 2 referime.



## 5. Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror

Gjatë vitit 2023 janë arrestuar, ndaluar si dhe me urdhër ndalimi të Prokurorit **693** persona, nga të cilët:

- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në Burg” për **353** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest në Burg” për **280** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në Shtëpi” për **16** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest në Shtëpi” **18** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Burg me Afat” për **1** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Burg me Afat” për **5** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Garanci Pasurore” për **3** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Garanci Pasurore” për **3** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje” për **318** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Detyrim për Paraqitje” për **383** të pandehur.



## 6. Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të marra gjatë vitit 2023, organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre. Më konkretisht gjatë vitit 2023, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kanë urdhëruar ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë për **344** të dënuar me burgim, për **118** persona me dënim më gjobë, për 17 persona me dënim plotësues dhe për **774** persona me dënime alternative. Nga këto janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi **437** vendime penale të evidentuar në tabelën e mëposhtme:

Llojet e dënimit	Urdhëruar ekzekutimi	Ekzekutuar	Të mbartura nga viti 2022 pa u ekzekutuar
<b>Burg</b>	344	53	760
<b>Gjobë</b>	118	15	655
<b>Dënim plotësues</b>	17	0	52
<b>Dënime alternative</b>	774	369	1015
<b>Gjithsej 2023</b>	<b>1253</b>	<b>437</b>	<b>2482</b>

Për ish-Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, për shkak të hartës së re gjyqësore, deri në datën 30 Prill të vitit 2023, për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të marra deri në datën 30 Prill të vitit 2023, organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre. Më konkretisht deri në datën 30 Prill të vitit 2023, prokurorët e ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë kanë urdhëruar ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë gjithsej për **61** vendime penale, ndër këto janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi, për **11** të dënuar me burgim, për **4** persona me dënim më gjobë, për dënim plotësues nuk ka patur të dënuar dhe për **30** persona me dënime alternative. Janë nxjerrë edhe **16** urdhëra për vazhdimin e masës mjekësore, revokimin e pezullimit të ekzekutimit, zgjatjen e shërbimit të proves, lirim para kohe me kusht, etj.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës i ka kushtuar një vëmendje problemit të ekzekutimit të vendimeve penale gjyqësore të formës së prerë, duke zbatuar dispozitat dhe kërkesat ligjore të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Në të gjitha rastet prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë ka nxjerrë urdhrat e ekzekutimit pasi i janë vënë në dispozicion vendimet penale të formës së prerë nga gjykata. Urdhrat e ekzekutimit janë nxjerrë brenda afateve ligjore dhe u janë dërguar për zbatim organeve të Policisë për masat sigurimit, I.E.V. Penale për dënimet me burgim dhe Zyrës Përmbarimore për dënimet me gjobë.

Krahas ekzekutimit të vendimeve penale të gjykatës prokurorët kanë marrë pjesë në gjykimin e kërkesave të veçanta të të dënuarve, për aplikimin e lirit me kusht, qëndrim në shtëpi etj. Gjatë vitit 2023 janë shqyrtuar gjithsej **165** kërkesa, kryesisht nga të dënuarit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës.

	<b>Kërkesa</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Pushuar</b>	<b>Rrëzuar</b>	<b>Transferuar</b>
Rivendosje në afat	<b>4</b>	<b>4</b>			
Shtyrje ekzekutimesh	<b>1</b>				
Shuarje dënimi	<b>6</b>	<b>3</b>			
Parashkrim	<b>5</b>	<b>3</b>			
Kujdestari	<b>1</b>	<b>1</b>			
N. 59/a K. Penal	<b>15</b>			<b>4</b>	
Lirim para kohe me kusht	<b>74</b>		<b>5</b>	<b>16</b>	<b>2</b>
Heqje zotësie	<b>33</b>	<b>19</b>			
Pezullim ekzekutimi					
Të tjera (shpall.zhduk/vdekur; rishikim vendimi etj.)	<b>6</b>	<b>2</b>		<b>1</b>	
Llogaritje paraburgimi	<b>3</b>				
Plotësim vendimi	<b>4</b>				
Vep.direkte	<b>13</b>	<b>3</b>	<b>6</b>		
<b>Totali</b>	<b>165</b>	<b>35</b>	<b>11</b>	<b>21</b>	<b>2</b>

Gjithashtu në Seksionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale është kushtuar vëmendje kërkesave të sjella nga Shërbimi i Provës në lidhje me mospermbushje të dënimeve alternative të dënuarëve. Gjatë vitit 2023 janë dërguar 64 kërkesa për revokim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga të cilat: 3 (tre) kanë përfunduar, në 5 (pesë) raste nuk ka marrë vendimi formë të prerë dhe të tjerat janë në proces gjykimi.

Nga ana e Zyrës së Ekzekutimit të Vendimeve Penale, mbi bazën e kërkesave të ardhura nga IEVP-të për bashkim dënimesh, në Gjykatë janë dërguar 6 ( gjashtë ) kërkesa, nga të cilat 5(pesë) janë pranuar dhe 1( një) në gjykim.

Me zyrën e Shërbimit të Provës në Durrës dhe në Kavajë ka bashkëpunim të mirë në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me kusht, si dhe për njoftimin e personave për t'u paraqitur për shkak të adresave jo të sakta dhe të mosmarrjen djeneri për ekzekutimin e vendimeve, në baze të kërkesave të ardhura nga Shërbimi i Provës nga Zyra e Ekzekutimit janë berë 10 (dhjetë) paralajmërime të personave për tu paraqitur në Zyrën e Shërbimit të Provës për të ekzekutuar vendimin penal.

Për rritjen e efektivitetit të punës lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale është forcuar bashkëpunimi me organet e policisë, veçanërisht për personat e dënuar të shpallur në kërkim, ku çdo muaj analizohet ky problem duke rakorduar dhe pasqyruar në vazhdimësi ndryshimet e listës së personave në kërkim. Megjithë përmirësimet e bëra dhe të evidentuara përsëri vazhdon që të ketë vendime gjyqësore penale të formës së prerë të paekzekutuara.

Mbikqyrja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në veçanti për vënien në ekzekutim të dënimeve me burgim si dhe respektimi i të drejtave të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim mbetet një ndër drejtimit e punës tonë me synim riedukimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve në shoqëri, duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën tonë me atë të Z.V.Sh. Provës. Në këtë drejtim mendoj se duhet të punohet për arritjen e një politike dënimi e cila duke marrë parasysh gjendjen e kriminalitetit

në rrethin e Durrësit dhe specifikat psiko-sociale të shoqërisë, të mbështetet në parimin që nëpërmjet dënimeve gjyqësore të arrihet goditja e krimit dhe jo e shoqërisë.

Rezultatet e sipërpërmendura në treguesit kryesorë të aktivitetit të organit të Prokurorisë Durrës janë rrjedhojë e rritjes së përgjegjësisë për realizimin e detyrave nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, është forcimi i disiplinës në punë dhe i kërkesës së vazhdueshme për realizimin e objektivave dhe veprimeve proceduriale penale. Në këtë drejtim analizat e vazhdueshme dhe ato herë pas here me prokurorët dhe oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore kanë rritur shpejtësinë në hetimet paraprake dhe u janë dhënë zgjidhje ligjore si kallëzimeve ashtu dhe procedimeve penale në hetim.

## 7. Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencat e tyre

**Për vitin 2023 vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprat penale si më poshtë:**

-“Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 20, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 21 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 5%.

-“Veprat penale të korrupsionit” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 11, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 16 procedime, gjë e cila tregon një **rritje** prej 45.45%.

-“Mashttrimet” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 68, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 69 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 1.47%.

-“Veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 90, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 91 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 1.11%.

-“Vepra penale kundër drejtësisë” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 35, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 67 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 182.8%.

-“Vepra Penale kundër Shëndetit të Kryera me Dashje” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 49, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 54 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 10.2%.

-“Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 49, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 67 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 36.73%.

-“Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 11, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 20 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 81.81%.

-“Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 469, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 602 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 28.35%.

-“Veprat penale të trafiqeve të paligjshme” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 28, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 61 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 117.85%.

-“Vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 11, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 14 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 27.27%

-“Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve” rezulton se në vitin 2022 është regjistruar 1 procedim, ndërsa në vitin 2023 është regjistruar 7 procedim, duke sjellë një **rritje** prej 600%.

-“Krime kundër jetës të kryera me dashje” rezulton se në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 20, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 25 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 25%.

-“Vepra penale e shkatërrimit të pronës” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 71, ndërsa në vitin 2022 janë regjistruar 105 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 47.88%.

-“Vepra Penale kundër Shëndetit të Kryera nga Pakujdesia” rezulton se në vitin 2023 kemi 1 procedim të regjistruar , ndërsa në vitin 2022 nuk kemi procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 100%.

-“Vjedhja e pasurisë” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 821, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 972 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 18.39%.

-“Vepra penale kundër mjedisit” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 9, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 18 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 100%.

-“Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 2, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 3 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 50%.

-“Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 4, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 6 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 33.33%.

-“Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 11, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 17 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 54.54%.

-“Vepra penale kundër krimit kibernetik” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 8, ndërsa në vitin 2023 kemi patur 23 procedime të regjistruara, duke sjellë një **rritje** prej 187.5%.

-“Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës” rezulton se në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 72, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 73 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 1.38%.

-“Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 39, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 62 procedime gjë e cila tregon një **rritje** prej 58.97%.

### **Përsa i përket veprave penale të mëposhtme vihet re një ulje e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2023:**

-“Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 7, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 2 procedime gjë e cila tregon një **ulje** prej 71.42%.

-“Vepra penale zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 21, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 16 procedime gjë e cila tregon një **ulje** prej 23.8%.

-“Krime në fushën e doganave” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 45, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 35 procedime gjë e cila tregon një **ulje** prej 22.22%.

-“Krime kundër autoritetit të shtetit” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 29, ndërsa në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara është 27 , duke sjellë një **ulje** prej 6.89%.

-“Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 71, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 51 procedime gjë e cila tregon një **ulje** prej 28.16%.

-“Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 198, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 182 procedime gjë e cila tregon një **ulje** prej 8.08%.

-“Krimet seksuale” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 19, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 15 procedime gjë e cila tregon një **ulje** prej 21.05%.

-“Vepra penale kundër lirisë së personit” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 14, ndërsa në vitin 2023 janë regjistruar 9 procedime gjë e cila tregon një **ulje** prej 35.71%.

-“Vepra penale kundër lirisë së besimit” rezulton se në vitin 2023 nuk është regjistruar asnjë procedim njëloj si në vitin 2022.

-“Krimet kundër jetës shkaktuar me pakujdesi” rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara ka qenë 1, njësoj dhe në vitin 2023.

## 8. Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal

### Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2023, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.

Për vitin 2023, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë sipas vendimeve penale të parashikuara nga Kodi Penal, nga analiza e të dhënave statistikore rezulton se:

-Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje (25 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.93%.

-Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera nga pakujdesia (1 procedim të regjistruar)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.03%.

-Raporti që zënë **vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje (54 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 2%.

-Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës (20 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.74%.

-Raporti që zënë **krimet seksuale (15 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.55%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit (9 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.33%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit (21 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.78%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes (182 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 6.77%.

-Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare (6 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.22%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit (asnjë procedim i regjistruar)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0%.


-Raporti që zënë **veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë (972 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 36.17%.

-Raporti që zënë **mastrimet (69 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 2.56%.

-Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës (105 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 3.9%.

-Raporti që zënë **veprat penale që cënojnë regjimin juridik të tokës (73 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 2.71%.

## Viti 2023



- krimet kundër jetës të kryera me dashje
- krimet kundër jetës të kryera nga pakujdesia
- vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje
- veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës
- krimet seksuale
- veprat penale kundër lirisë së personit
- veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit
- veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes
- veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare
- veprat penale kundër lirisë së besimit
- veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë
- mashtrimet
- shkatërrimi i pronës
- veprat penale që çenojnë regjimin juridik të tokës
- veprat penale kundër mjedisit
- veprat penale në lidhje me veprimtaritë bankare dhe financiare
- krimet në fushën e doganave
- veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet
- falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë
- falsifikimi i dokumenteve
- zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit
- krimet kundër autoritetit të shtetit
- krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetëror ose në shërbimin publik
- krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetëror ose në shërbimin publik
- vepra kundër rendit dhe sigurisë publike
- vepra kundër pastrimit të produkteve të veprës penale
- vepra kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë
- veprat penale kundër drejtësisë
- vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve
- veprat penale kundër korrupsionit
- veprat penale të krimit kibernetik
- veprat penale të trafikëve të paligjshme
- veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve

- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit (18 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.66%.
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtaritë bankare dhe financiare (2 procedim i regjistruar)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.07%.
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave (35 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 1.3%.
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet (17 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.63%.
- Raporti që zënë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë (3 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.11%.
- Raporti që zënë **falsifikimi i dokumenteve (51 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 1.89%.
- Raporti që **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit (16 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.59%.
- Raporti që zënë **krimet kundër autoritetit të shtetit (27 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 1%.
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetëror ose në shërbimin publik (67 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 2.49%.
- Raporti që zënë **vepra kundër rendit dhe sigurisë publike (602 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 22.4%.
- Raporti që zënë **vepra kundër pastrimit të produkteve të veprës penale (14 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.14%.
- Raporti që zënë **vepra kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë (62 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 2.3%.
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë (67 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 2.49%.
- Raporti që zënë **vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve (7 procedime të regjistruar)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.26%.
- Raporti që zënë **veprat penale kundër korrupsionit (16 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.59%.
- Raporti që zënë **veprat penale të krimit kibernetik (23 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 0.85%.
- Raporti që zënë **veprat penale të trafikëve të paligjshme (61 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 2.27%.
- Raporti që zënë **veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve (91 procedime të regjistruara)**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023 është 3.37%.



### III. Treguesit statistikorë 2-vjeçar të veprave penale sipas strukturës së kodit penal

Në tërësinë e veprave penale të regjistruara gjatë vitit 2023 organi i prokurorisë është fokusuar në mënyrë të veçantë në disa çështje specifike për të cilat trupa e prokurorëve kanë qenë të përqëndruar në hetimin e tyre, të cilat janë:

#### KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

“Krime kundër jetës të kryera me dashje” përbën një nga grupet e veprave penale që kërkojnë vemëndje maksimale, pasi lidhen drejtpërdrejtë me sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2023 janë regjistruar 25 procedime penale, ndërsa në vitin 2022 janë regjistruar 20 procedime penale gjë që tregon një rritje prej 25% të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash në krahasim me vitin 2022.

Gjithsesi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duhet theksuar se gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022, ka ndryshuar numri i procedimeve penale në veprën penale me të rëndësishme, të përfshirë në këtë grup, e cila është “vrasje në rrethana cilësuese”, ku konstatohet se kemi 3 procedime penale të regjistruara në vitin 2023, ndërsa në vitin 2022 konstatohet se nuk kemi procedime penale të regjistruara. Ndërkohë, vërehet një ulje me 100% të procedimeve penale për veprën “vrasje me paramendim”, nuk kemi procedime penale të regjistruara në vitin 2023 krahasuar me 3 procedime penale i regjistruar në vitin 2022.

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2023 është 0.93% e numrit total të procedimeve penale të regjistruara, ndërsa për vitin 2022 ky grup veprash përbënte 0.87% të totalit të procedimeve. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja	2	7	2	7	1	10	4	9	4	2
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	3	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje	0	0	0	0	1	1	0	1	0	0
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	0	0	0	0	0	3	0	1	0	1
Neni 79/ç Vrasja e funksionarëve publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 80	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 81 Vrasja e foshnjës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84 Kanosja	15	4	6	6	4	11	3	2	3	0
<b>Totali</b>	<b>20</b>	<b>11</b>	<b>9</b>	<b>13</b>	<b>6</b>	<b>25</b>	<b>8</b>	<b>13</b>	<b>8</b>	<b>3</b>

Ndërkohë kemi një ulje prej 27.27% të procedimeve të dërguara për gjykim, 8 procedime në vitin 2023 në krahasim me 11 procedime penale të vitit 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje prej 44.44% e numrit të pandehurve të regjistruar, 13 të pandehur në vitin 2023 përkundrejt këtij totali në vitin 2022 me 9 të pandehur, ulje prej 38.46% e numrit të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit, 8 të pandehur në vitin 2023 dhe 13 të pandehur në vitin 2022 si dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 3 të pandehur në vitin 2023, kundrejt 6 të pandehurve në vitin 2022.

### KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprën penale të cilat parashikohen në Kreun “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	1	0	1	0	1	1	1	1	1	0
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 kemi një numër të njëjtë të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi” në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me procedimet e dërguara për gjykim, të pandehurit e dërguar për gjykim si dhe të pandehurit e dënuar kemi një rritje me 100%.

### VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2023 është 2%, ndërsa për vitin 2022 ky grup veprash përbënte 1.38% të totalit të procedimeve. Pra, vihet re një rritje e lehtë për vitin 2023 nga viti 2022.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 88 Plagosje e rëndë	10	5	9	7	6	12	7	14	11	0
Neni 88/b Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijev të mbrojtjes së nevojshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	39	22	26	25	4	42	15	16	30	5
<b>Totali</b>	<b>49</b>	<b>27</b>	<b>35</b>	<b>32</b>	<b>10</b>	<b>54</b>	<b>22</b>	<b>30</b>	<b>41</b>	<b>5</b>

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2023 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës janë regjistruar 54 procedime penale krahasuar me 49 procedime të regjistruara në vitin 2022, çka tregon një rritje prej 10.2% e numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra Penale Kundër Shëndetit të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2022. Por tendencë në ulje prej 18.5% paraqet numri i procedimeve të dërguara për gjykim, 22 procedime në vitin 2023 në krahasim me 27 procedime në vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje në masën 14.28% e numrit të pandehurve të regjistruar, 30 të pandehur në vitin 2023 përkundrejt këtij totali me 35 të pandehur në vitin 2022, rritje me 28.12% e numrit të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit, 41 të pandehur në vitin 2023 krahasuar me 32 të pandehur në vitin 2022.

### VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand dënuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 90 Dëmtime të tjera me dashje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia	0	1	0	1	0	1	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Sikurse vihet re edhe nga tabela, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në vitin 2023 ka një rritje me 100% të numrit të procedime të regjistruara.

### VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 është 0.74%. Ky tregues për vitin 2022 ka qenë 0.48%, pra vihet re një rritje e lehtë për vitin 2023.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	3	0	0	0	0	4	0	0	0	0
Neni 97 Mosdhënia ndihmës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

<b>Neni 98</b> Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 99</b> Shkaktimi i vetëvrasjes	8	1	1	1	0	16	0	0	0	1
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>20</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 ka një rritje prej 81.81% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës, 20 procedime në vitin 2023 në krahasim me 11 procedime të regjistruara vitin 2022. Ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata për vitin 2023 është 1.

## KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2023 është 0.56%, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 0.82%. Pra vihet re ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

KRIME SEKSUALE	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 100</b> M. Sek/ homoseksuale me të mitur	1	2	1	2	1	2	0	0	0	3
<b>Neni 101</b> M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	0	1	0	1	0	4	0	2	0	0
<b>Neni 102</b> M. Seksuale me dhunë me të rritura	4	2	4	2	1	1	1	0	1	3
<b>Neni 102/a</b> M. Homoseksuale me dhunë me të rritur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 103</b> M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur	0	1	0	1	0	1	0	0	0	0
<b>Neni 104</b> Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërkçënim me përdorimin e armës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 105</b> M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 106</b> M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0
<b>Neni 108</b> Vepra të turpshme	2	1	0	1	0	0	1	0	1	0
<b>Neni 108/a</b> Ngacmimi seksual	12	6	7	6	0	7	6	2	6	2
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>14</b>	<b>12</b>	<b>14</b>	<b>3</b>	<b>15</b>	<b>8</b>	<b>4</b>	<b>8</b>	<b>8</b>

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 21% të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale, 15 procedime të regjistruara në vitin 2023 në krahasim me 19 procedime në vitin 2022. Kemi ulje prej 42.85% të procedimeve të dërguara për gjykim, 8 procedime në vitin 2023 në krahasim me 14 procedime në vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar, 4 të pandehur të regjistruar në vitin 2023 kundrejt 12 të pandehur në vitin 2022. Ulje me 42.85% e numrit të pandehurve të cilët i janë dërguar

gjyqit, 8 të pandehur në vitin 2023 përkundrejt 14 të pandehurve në vitin 2022. Rritje me 166.6% e të pandehurve të dënuar nga gjykata, 8 të pandehur në vitin 2023, krahasuar me 3 të pandehur të dënuar në vitin 2022.

Përsa i përket këtyre grup veprave penale, vlen të theksohet se i është kushtuar rëndësi e veçantë hetimit të tyre dhe për të gjitha rastet është kërkuar masa e arrestit në burg, si dhe është treguar kujdes gjatë pyetjes së viktimave në respektim të dispozitave të Kodit Penal për të Mitur. Për trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave nga prokurorët që kanë ndjekur këto çështje i është kërkuar Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkisë marrja e masave për ofrimin e asistencës së plotë psikologjike. Në këtë kuadër edhe organizma joqeveritarë kanë ofruar ndihmën e tyre për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin.

### VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2023 është 0.33%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 0.61%. Pra vihet re një ulje për vitin 2022.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 109</b> Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 109/a</b> Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 109/b</b> Shtrengimi me ane te kanoşjes ose dhunes per dhenien e pasurisë	5	2	1	2	0	5	0	4	0	0
<b>Neni 109/c</b> Zhdukja me force	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 110</b> Heqja e paligjshme e lirisë	8	5	8	7	0	3	2	4	6	2
<b>Neni 111</b> Rrëmbimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 112</b> Dhunimi i banesës	1	1	0	1	0	1	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>14</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>	<b>0</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>2</b>

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 kemi ulje me 35.71%, procedime të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit”, pra 9 procedime në vitin 2023 në krahasim me 14 procedime në vitin 2022. Kemi ulje me 75% të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2022, 2 procedime në vitin 2023 krahasuar me 8 procedime në vitin 2022. Gjithashtu kemi ulje me 11.11% të numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2023, 8 të pandehur të regjistruar në vitin 2023 përkundrejt 9 të pandehur në vitin 2022. Ulje me 40% të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit, 6 të pandehur në vitin 2023 krahasuar me 10 të pandehur në vitin 2022. Është rritur numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, duke patur një rritje në masën 100%.

**VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 është 0.78%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 0.87%. Pra, vihet re një rritje e lehtë në krahasim të viteve.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2022					2023				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 113</b> Prostitucioni	0	0	0	0	0	3	1	6	4	0
<b>Neni 114</b> Shfrytëzimi i prostitucionit	6	0	0	0	2	3	0	6	2	0
<b>Neni 115</b> Mbajtja e lokaleve për prostitucion	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 117</b> Pornografia	2	1	1	1	0	6	0	0	0	0
<b>Neni 118</b> Dhunimi i varreve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 119</b> Fyerja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 120</b> Shpifja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 121</b> Ndërhyrje të padrejta në jetën private	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 121/a</b> Përndjekja	9	3	6	3	2	9	4	9	5	1
<b>Neni 122</b> Përhapja e sekreteve vetjake	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 123</b> Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>20</b>	<b>4</b>	<b>8</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>21</b>	<b>5</b>	<b>21</b>	<b>11</b>	<b>1</b>

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara është 21, ndërkohë që në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara është 20, duke sjellë kështu një rritje në masën 5% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”, në krahasim me vitin 2022. Ndërkaq në vitin 2022 kemi 4 procedime të dërguara për gjykim, ndërkohë që në vitin 2023 numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 5, duke sjellë një rritje në masën 25% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, në vitin 2022 numri i të pandehurve të regjistruar është 8, ndërkohë në vitin 2023 numri i të pandehurve të regjistruar është 21, duke sjellë kështu një rritje në masën 162.5%. Sa i përket numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit në vitin 2022 numri i tyre është 4, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 11, duke sjellë kështu një rritje prej 175%. Gjithashtu, në vitin 2022 numri i të dënuarve është 4, ndërsa në vitin 2023 është 1.

**VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES**

Gjatë vitit 2023 konstatohet angazhim specifik i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës lidhur me evidentimin, hetimin dhe dënimin e “veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”. Gjithashtu, konstatohet se numri i procedimeve penale të hetuara në vitin 2023 për këtë grup veprash penale është më i ulët krahasuar me atë të vitit 2022. Nga hetimet e pjesës më të madhe të rasteve, rezulton se viktimat kanë qenë në ushtrimin e dhunës për një kohë të gjatë dhe janë ndërgjegjësuar për raportimin e këtyre rasteve pranë organeve shtetërore. Gjithashtu, vlerësojmë se një rol pozitiv në shtimin e kallëzimeve për këtë vepër penale ka dhënë edhe media.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 është 6.77%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 8.64%. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES	2022					2023				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur	1	0	0	0	0	3	2	2	2	0
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit	9	6	5	6	3	3	3	1	3	2
Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës	1	0	1	0	0	2	0	0	0	0
Neni 128 Ndërimi i fëmijëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 128/a Fshehja ose ndërimi me dashje I fëmijës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 129 Shtytja e të miturve në krim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë	1	1	1	1	0	2	0	1	0	1
Neni 130/a Dhuna në familje	186	138	147	143	100	172	129	143	140	60
<b>Totali</b>	<b>198</b>	<b>145</b>	<b>154</b>	<b>150</b>	<b>103</b>	<b>182</b>	<b>134</b>	<b>147</b>	<b>145</b>	<b>63</b>

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara është 198, ndërkohë që në vitin 2023 është 182, duke sjellë një ulje në masën 8.08% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” në krahasim me vitin 2022. Ndërkaq numri i procedimeve të dërguara për gjykim në vitin 2022 është 145, ndërsa në vitin 2023 numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 134, duke sjellë një ulje në masën 7.58% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, në vitin 2022 numri i të pandehurve të regjistruar është 154, ndërkohë që në vitin 2023 numri i të pandehurve të regjistruar është 147, duke sjellë kështu një ulje në masën 4.54%. Numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit në vitin 2022 është 150, ndërkohë që në vitin 2023 numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është 145. Ndërkohë, në vitin 2022 numri i të pandehurve të dënuar për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” është 103, ndërkohë që në vitin 2023 numri i të pandehurve të dënuar është 63, duke sjellë kështu një



ulje në masën 38.83%. Një vend të veçantë në grupin e “Veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” zë “dhuna në familje”. Vihet re se në vitin 2023 janë regjistruar 172 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”, ndërkohë që në vitin 2022 ky numër ka qenë 186. Janë dërguar në gjykim 129 procedime penale nga ana e organit të prokurorisë në vitin 2023, në vitin 2022 ky tregues ka qenë 138. Në vitin 2023 janë regjistruar 143 të pandehur dhe është ngritur akuzë në gjykatë për 140 të pandehur. Janë dënuar nga gjykata 60 të pandehur për vitin 2023, ndërsa në vitin 2022 janë dënuar 100 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”. Vepra penale e parashikuar nga neni 124/b paragrafi i dytë i Kodit Penal, detyrimi i të miturve për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij, mbetet ende një problem shqetësues.

### LIRIA E BESIMIT

Për këtë grup veprash penale të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2023 nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 131</b> Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 132</b> Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 133</b> Pengimi i ceremonive fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

### VJEDHJA E PASURISË

Nga të dhënat statistikore, rezulton se numri më i madh i procedimeve penale për vitin 2023 vijon të mbetet grupi i veprave penale “vjedhja e pasurisë”. Pësia specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2022 është 36.17%, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 35.85%. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022. Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara është 821, ndërkohë që në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara është 972, duke sjellë kështu një rritje në masën 18.39%. Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore përsa i përket numrit të procedimeve të dërguara për gjykim, në vitin 2022 numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 108, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 155, duke sjellë kështu një rritje në masën 43.51%. Po ashtu, ka ulje të procedimeve penale për “vjedhje me dhunë” prej 14.28% krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë, kemi një ulje të shifrave në procedimet penale për “vjedhje me armë”, pasi kemi 2 procedime të regjistruara në vitin 2022, ndërkohë kemi 1 në vitin 2023. Përsa i përket veprës penale “vjedhja me pasojë vdekjen” në vitin 2023 nuk është regjistruar asnjë procedim penal njëjloj me vitin 2022.



VJEDHJA E PASURISË	2022					2023				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 134</b> Vjedhja	788	97	116	109	40	933	128	148	157	60
<b>Neni 135</b> Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	8	6	5	7	1	7	7	2	9	2
<b>Neni 136</b> Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursim.	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
<b>Neni 137</b> Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	9	6	7	6	2	17	12	3	12	4
<b>Neni 137/a</b> Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 138</b> Vjedhja e veprave të artit e kulturës	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0
<b>Neni 139</b> Vjedhja me dhunë	14	4	7	6	3	12	6	5	6	5
<b>Neni 140</b> Vjedhja me armë	2	1	0	2	0	1	0	0	0	0
<b>Neni 141</b> Vjedhja me pasojë vdekjen	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 142</b> Sigurimi i mjeteve për vjedhje	0	0	0	0	0	1	1	0	3	0
<b>Totali</b>	<b>821</b>	<b>108</b>	<b>135</b>	<b>130</b>	<b>49</b>	<b>972</b>	<b>155</b>	<b>159</b>	<b>188</b>	<b>71</b>

Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re se në vitin 2022 numri i të pandehurve të regjistruar është 135, ndërkohë që në vitin 2023 numri i të pandehurve të regjistruar është 159, duke sjellë kështu një rritje në masën 17.77%. Në vitin 2022 numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është 130, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 188, duke sjellë një rritje në masën 44.61%. Gjithashtu, në vitin 2022 numri i të pandehurve të dënuar është 49, ndërkohë që në vitin 2023 numri i të pandehurve të dënuar për “Veprat penale të vjedhjes së pasurisë” është 71, duke sjellë kështu një rritje në masën 44.89%.

**MASHTRIMET**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 është 2.56%, ndërsa në vitin 2022 është 2.96%. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

MASHTRIMET	2022					2023				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 143</b> Mashtrimi	65	19	6	23	15	68	12	14	23	3
<b>Neni 143/a</b> Skemat mashtruese dhe piramidale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 143/a/1</b> Manipulimi i tregut	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 143/a/2</b> Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 143/a/3</b> Manipulimi i cmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 143/a/4</b> Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 143/a/5</b> Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 143/a/6</b> Fshehja e pronësisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara është 28, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 61, duke sjellë një rritje në masën 117%. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 3 në vitin 2022, ndërsa në vitin 2023 ky numër është 7, duke sjellë një rritje me 133%. Në lidhje me të pandehurit e regjistruar për këtë grup veprash penale në vitin 2022 numri i tyre është 8, ndërsa në vitin 2023 është 7, duke sjellë një ulje prej 12.5%. Sa i përket të pandehurve të dërguar për gjykim numri i tyre në vitin 2022 është 3, ndërsa në vitin 2023 është 9, duke sjellë një rritje me 200%.

**PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 është 3.38%, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 3.13%. Vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2022					2023				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 283</b> Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	74	32	70	43	48	85	42	67	55	23
<b>Neni 284</b> Kultivimi i bimëve narkotike	16	5	6	8	7	5	2	2	3	3
<b>Neni 284/a</b> Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 284/c</b> Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 285</b> Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>90</b>	<b>38</b>	<b>76</b>	<b>52</b>	<b>53</b>	<b>91</b>	<b>44</b>	<b>69</b>	<b>58</b>	<b>26</b>

Siç vërehet edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2022 numri i procedimeve të regjistruara është 90, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 91, duke sjellë një rritje në masën 1.11%. Në vitin 2022 numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 38, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 44, duke sjellë një rritje në masën 15.78%. Numri i të pandehurve të regjistruar në vitin 2022 është 76, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 69, duke sjellë një ulje në masën 9.21%. Në vitin 2022 numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është 52, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 58, duke sjellë një rritje në masën 11.53%. Gjithashtu në vitin 2022 numri i të pandehurve të dënuar është 53, ndërkohë që në vitin 2023 numri i tyre është 26, duke sjellë një ulje në masën 50.94%.

**KRIMI I ORGANIZUAR**

KRIMI I ORGANIZUAR	2022					2023				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
<b>Neni 333</b> Organizata kriminale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Neni 333/a</b>	1	0	8	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Siç vërehet edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezultojnë se kemi vetëm 1 procedim penal të regjistruar në vitin 2022 i cili është dërguar për kompetencë SPAK-ut.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> V.O. Procedimet e dërguara për gjykim janë edhe procedimet e mbartura.

#### IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë

##### 1. Treguesit e efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale, raporti i çështjeve dhe të pandehurve të dërguara me kërkesë për gjykim me ato të pushuara, dhe raporti i çështjeve të pezulluara me çështjet e përfunduara në hetimeve të paraprahe

Në vitin 2023 janë përfunduar hetimet për **2545** procedime penale, me **1453** të pandehur me, që zënë **52.45%** të procedimeve penale të ndjekura. Nga këto është vendosur pezullimi i hetimeve për **989** procedime penale, që zënë **38.86%** të procedimeve penale të përfunduara.

Janë dërguar për gjykim **1043** procedime penale, me **1289** të pandehur, ndërkohë që janë pushuar **451** procedime penale me **134** persona nën hetim. Pra kemi një raport më të madh krahasimor në procedimet penale për gjykim me ato të pushuara.


##### 2. Treguesit e efektivitetit në gjykim dhe në dënimin e të pandehurve

Një pjesë të konsiderueshme të ngarkesës së punës së secilit prokuror zë edhe pjesëmarrja në gjykim, të cilën e kemi analizuar si një tregues të veçantë të punës së secilit prokuror. Vihet re, një tregues në rritje i cilësisë në ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe një numër i lartë i dërgimit të çështjeve në gjykim. Kështu rezulton se gjatë këtij viti prokurorët kanë përfunduar gjykimin e këtyre çështjeve penale.

Gjatë vitit 2022, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kanë përfaqësuar akuzën në gjykimet penale të **530** çështjeve, në ngarkim të **585** të pandehurve, prej të cilëve **81** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Krahasuar me një vit më parë kemi një rritje të procedimeve penale në masën **46.8%** të të pandehurve ndaj të cilëve është përfaqësuar akuza në gjykatë, sipas tabelës së mëposhtme:

Vitet	Gjykuar		
	Procedime	Pandehur	Arrestuar
<b>2022</b>	<b>740</b>	<b>854</b>	<b>112</b>
<b>2023</b>	<b>530</b>	<b>585</b>	<b>81</b>
<b>Krahasimi</b>	<b>Ulur 28.37%</b>	<b>Ulur 31.49%</b>	<b>Ulur 27.67%</b>





### 3. Të dhëna për gjykimet e posaçme

Analiza e treguesve sipas llojeve të gjykimit të ekspozuara në tabelën e mëposhtme evidenton se:

Për **82.7%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i shkurtuar, konkretisht për 440 çështje të gjykuara në vitin 2023 krahasuar me 670 çështje të gjykuara në vitin 2022, ose 34.32% më shumë se në vitin 2022.

Për **0.93%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i zakonshëm, konkretisht për 5 çështje të gjykuara në vitin 2023 krahasuar me 2 çështje të gjykuara në vitin 2022, ose 150% më shumë se në vitin 2022.


Për **15.97%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i drejtpërdrejtë, konkretisht për 85 çështje të gjykuara në vitin 2023 krahasuar me 68 çështje të gjykuara në vitin 2022, ose 25% më shumë se në vitin 2022.

Për **0.18%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi me marrëveshje për pranimin e fajësisë, konkretisht për 1 çështje të gjykuara në vitin 2023 krahasuar me 4 çështje të gjykuara në vitin 2022, ose 75% më pak se në vitin 2022.

Për **0.18%** të çështjeve të gjykuara është aplikuar miratimi i urdhrit penal, konkretisht për 1 çështje të shqyrtuar në vitin 2023 krahasuar me 5 çështje të shqyrtuara në vitin 2022, ose 80% më pak se në vitin 2022.

Në vitin 2023 nuk është aplikuar çështje gjykimi në mungesë.

Vitet	Llojet e Gjykimit					
	Drejtpërdrejtë	Zakonshëm	Shkurtuar	Në Mungesë	Urdhër Penal	Marrëveshje e fajësie
2023	85	5	440	0	1	1
2022	68	2	670	0	5	4
<b>Krahasimi</b>	<b>Rritur 28.42%</b>	<b>Rritur 88.8%</b>	<b>Ulje 71.3%</b>	<b>Njëlloj</b>	<b>Ulje 400%</b>	<b>Ulje</b>



Në gjykimin e këtyre çështjeve prokurorët kanë kërkuar krahas deklaratimit fajtor, dënimin e të pandehurve me lloje dënimi si: **12 persona me gjobë** dhe **176 persona me burgim**. Kërkesat për dënimin me burgim zënë 33.08% të kërkesave të prokurorëve. Gjithashtu këtë vit prokurorët kanë kërkuar pushimin e akuzës dhe pushimin e çështjes në gjykim për **3** çështje penale.

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, mbi këto kërkesa ka vendosur për deklarimin fajtor me Gjobë për **13** persona, dënim me burg **166** të pandehur, dënim në lidhje me nenin 59 të K. Penal janë **391** të pandehur, pushim çështje dhe akuze për **4** çështje penale, pafajësi për **8** të pandehur.

### **Të dhëna në lidhje me seancat e gjykimeve paraprake**

Me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale, me Ligjin nr. 35/2017 datë 05.05.2017, hyrë në fuqi më datë 01.08.2017 tashmë ka ndryshuar roli i Prokurorit në hetim dhe gjykim. Prokurori nuk është më në rolin e vendimmarrësit në rastet e gjykimit të çështjeve dhe të pushimit të tyre për veprat penale që përbëjnë krime, por në rolin e kërkuesit.

Si pasojë e këtyre ndryshimeve ligjore ka patur problematika të shumta në lidhje me vlerësimin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim apo të kërkesave për pushimin e çështjeve gjatë seancës paraprake. Rezulton se ka patur raste të kthimit të dosjeve për plotësim si të atyre të dërguara për gjykim ashtu dhe për pushim.

Në zbatim të dispozitave procedurale penale nga ana jonë janë analizuar rastet, rast pas rasti, duke kryer veprimet hetimore kur vendimi i gjykatës ka qenë i arsyetuar, por duke bërë dhe ankim ndaj vendimeve gjyqësore në rastet kur në vlerësimin tonë vendimet kanë qenë të padrejta dhe të pambështetura në ligj.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mbi bazën e ndryshimeve të K.Pr.Penale, janë dërguar kërkesa për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për 350 çështje, nga të cilat janë shqyrtuar 125 kërkesa, prej tyre janë kthyer aktet për **10** raste.

Gjithashtu, vlen të përmendet se, gjatë vitit 2023 janë kthyer nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe 30 kërkesat e dërguara gjatë vitit paraardhës, nga të cilat janë dërguar përsëri më kërkesa të njëjta 14 procedime penale.

Përsa i përket çështjeve të dërguara për gjykim, janë dërguar **1043** kërkesa dhe miratuar pjesa më e madhe e tyre. Gjatë seancave paraprake, është pushuar çështja nga Gjykata e Rrethit për **1** rast gjithashtu janë kthyer aktet nga Gjykata e Rrethit për **3** raste.

Përsa i përket çështjeve të dërguara me kërkesë për miratim marrëveshje fajësie, nuk kemi të dhëna të rasteve të kthimit të akteve nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, kjo dhe për faktin se në vitin 2023 kemi një ulje të numrit të urdhrave penalë apo marrëveshjeve të fajësisë nga ana e prokurorëve.

Duhet theksuar fakti, se në lidhje me numrin e ulët të vendimeve për seancat paraprake, ka ndikuar caktimi i seancave në kohë të gjatë nga ana e Gjykatës së Rrethit.

### **4. Të dhënat mbi llojet dhe masat e dënimeve**

Kërkesa e prokurëve dhe vendimet e gjykatës për llojin dhe masën e dënimit për të pandehurit paraqitet sipas tabelës (të dhënat janë në përputhje me evidencat e dorëzuara nga prokurorët).

	<b>2023</b>	<b>2022</b>	<b>Krahasimi</b>
--	-------------	-------------	------------------

Lloji i kërkesës	Kërkesa e Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa e Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa e Prokurorit	Vendime Gjykatës
<b>Gjobë</b>	12	13	52	54	Ulur 76.92%	Ulur 75.92%
<b>Burgim</b>	176	166	204	184	Ulur 13.72%	Ulur 9.78%
<b>Neni 59</b>	392	391	592	603	Ulur 33.78%	Ulur 35.15%
<b>T/Akteve</b>	2	3	1	0	Rritur 100%	Rritur 100%
<b>Pushuar</b>	3	4	5	7	Ulur 40%	Ulur 42.85%
<b>Pafajësi</b>	0	8	0	5	Njëlloj	Rritur 60%
<b>Përjashtim nga dënimi</b>	0	0	0	0	Njëlloj	Njëlloj

### TË DHËNA PËR PAFAJËSITË E VENDOSURA NGA GJYKATA NË VITIN 2023

Gjatë vitit 2023 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është dhënë vendim pafajësie për 8 të pandehur në kuadër të 5 procedimeve penale, 2 (dy) prej të cilave janë pafajësi të pjesshme, ndryshe nga kërkesa e prokurorit për deklarimin fajtor dhe dhënien e dënimit, sipas të dhënave më poshtë:

- Heqja e paligjshme e lirisë, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal.
- Shkaktimi i vetëvrasjes, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal.
- Dhuna në familje, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.
- Prodhimi dhe shitja e narkotike, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.
- Kryerja e veprimeve arbitrare, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal
- Moskallëzimi i krimit, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.


Njëkohësisht është dhënë vendim pushimi nga Gjykata e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për 4 të pandehur, sipas veprave penale të pasqyruara më poshtë:

- Prodhimi dhe shitja e narkotike, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.
- Mashtrimi, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.
- Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë, parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal.
- Plagosje e lehtë me dashje, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.


Në analizë të atyre vendimeve të arsyetura nga ana e prokurorëve është konstatuar se janë dhënë për interpretim ndryshe të ligjit dhe provave. Ndaj këtyre vendimeve prokurorët e cështjeve kanë paraqitur/do të paraqesin ankim në Gjykatën e Apelit.

## 6. Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit


Nga të dhënat statistikore rezulton se raporti i të pandehurve meshkuj-femra (1900 meshkuj dhe 69 femra) në vitin 2023 ka qenë 96.49% me 3.5%. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme:




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2023 rezultojnë 36.26% e të pandehurve me arsim deri 9-vjeçar (714), me arsim të mesëm (1118) rezultojnë 56.78%, ndërsa me arsim të lartë (137) rezultojnë 6.95% e të pandehurve.



Përsa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, rezulton se në vitin vitin 2022 të punësuar në sektorin shtetëror (86) rezultojnë 4.36% e të pandehurve, në sektorin privat (915) rezultojnë të punësuar 46.47% dhe të papunë (968) rezultojnë 49.16%.




Sikurse rezulton edhe nga tabela e mëposhtme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat, ndërkohë që për vitin 2023 në qytet (1660) banojnë 84.3% e të pandehurve, ndërsa në komunë (309) janë 15.69% e të pandehurve.



## 6. Të dhënat për pasojat e veprave penale

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me pasojat në dëm të jetës e shëndetit të regjistruara në vitin e fundit:



Peshën më të madhe të pasojave zë plagosja e lehtë me 128 persona (84.21%). Duke vijuar më tej me plagosjen e rëndë me 13 persona (8.55%) dhe duke përfunduar me vdekjen me 11 persona (7.23%).

## 5. TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT E MITUR

Numri i përgjithshëm i çështjeve me të mitur në konfliktet me ligjin është 104 procedime penale dhe numri i autorëve të mitur në këto çështje është 61 meshkuj dhe 3 femra, 5 prej të cilëve janë ndjekur me masë sigurimi Arrest me Burg, dhe 1 me masë sigurimi “Vendosje në mbikqyrje”. Nga procedimet penale të hetuara për këtë periudhë rezulton se në 109 prej tyre janë viktima të veprës penale. Numri i autorëve të mitur në konflikt me ligjin (autor të veprave penale), për të cilët është zbatuar masa e shmangies nga dënimi është 22. Nga procedimet penale të regjistruara është zbatuar masa alternative e shmangies (paralajmërim me shkrim) për 20 raste, ku 2 janë dërguar me kërkesë për gjykim dhe është vendosur masë detyruese.

- Në lidhje me masat e sigurimit personal nga prokurorët e seksionit të hetimit të veprave penale për të miturit, përgjatë vitit 2023 janë ndjekur me masë sigurimi personal “**Arrest në burg**” 5 të pandehur, ndërsa për 1 të pandehur të tjerë janë ndjekur me masë sigurimi personal “**Vendosja në mbikqyrje**”

Të pandehur të mitur hetuar	Të pandehur të mitur dërguar gjyqit	Të pandehur të mitur dënuar
64	2	—

Kërkesa e Prokurorit për dënimin e të miturve								Vendimi i Gjykatës për dënimin e të miturve							
Gjobë	Burgim						Perjashtim nga denimi	Gjobë	Burgim					Denim alternative	Perjashtuar nga denimi
	Paraburgim	Minimum	Mesatar	Maksimum	Neni 59	Denime alternative			Paraburgim	Minimum	Mesatar	Maksimum	Neni 59		
-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej:								Gjithsej dënime:							

Kërkesa të Prokurorit për Masa Sigurimi të pandehur të mitur								Vendime të Gjykatës për Masa Sigurimi të pandehur të mitur							
Arrest në Burg	Arrest Burg Mungesë	Arrest në Shtëpi	Arrest me Afat	Vendosja në mbikqyrje	Detyrim Paraqitje Pol. Gjyqësore	Gjithësej Masa Shtëpiaqësore	Masa Ndaluese	Arrest në Burg	Arrest Burg Mungesë	Arrest në Shtëpi	Arrest me Afat	Vendosja në mbikqyrje	Detyrim Paraqitje Pol.Gjyqësore	Gjithësej Masa Shtrënguese	Masa Ndaluese
5	-	-	-	1	-	6	-	5	-	-	-	1	-	6	-

## V. Të dhënat lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Prokurorët e Seksionit të hetimit për të miturit dhe Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, krijuar në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të Urdhrit Nr. 03, datë 06.02.2017, të përditësuar me urdhra riorganizimi në vitin 2019, përgjatë vitit 2023 janë përpjekur dhe kanë përballuar një volum të konsiderueshëm pune në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ligjore dhe procedurale me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës si dhe me kryerjen e mjaft procedurave të tjera ligjore, objekt i punës dhe i veprimtarisë ligjore të këtij seksioni.

Njëkohësisht veç sa më sipër tregues të qartë dhe konkret të një volumi të konsiderueshëm pune të prokurorëve të këtij seksioni kanë qenë dhe mbeten, kryerja në kohë dhe brenda afateve ligjore të procedurave që kanë të bëjnë me ekstradimet e personave, autorë të kryerjes së veprave të ndryshme penale, të cilët janë dënuar me burgim, me vendime të formës së prerë nga Gjykata, apo dhe autorë të këtyre veprave penale për të cilët është caktuar masë sigurimi, “Arrest në burg”.

### **-Ekstradimet**

Kështu përgjatë vitit 2023 nga seksioni i ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është kërkuar pranë kësaj Gjykate për **18** raste ekstradimi për jashtë vendit tonë i personave që janë dënuar me vendime të formës së prerë nga gjykatat e huaja apo për shkak të masave të sigurimit “Arrest në burg” që janë caktuar ndaj tyre nga po këto Gjykata.

Ndërsa përsa i përket procedurave ligjore të ekstradimit nga jashtë vendit tonë i personave që janë dënuar me vendime të formës së prerë nga Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës apo për shkak të masave të sigurimit “Arrest në burg” të caktuara nga po këto Gjykata, përgjatë vitit 2023 janë rregjistruar 7 raste..

### **-Njohjet e vendimeve penale të huaja**

Përgjatë vitit 2023 nga seksioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë kryer të gjitha procedurat e duhura ligjore në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës për “**Njohjen e Vendimit Penal të Huaj**” të cilat janë gjithsej në **5** raste konkrete.

### **-Letërporositë**

Njëkohësisht tregues të qartë dhe konkret të volumit të punës së Prokurorëve të këtij seksioni kanë qenë dhe mbeten, kryerja në kohë dhe brenda afateve ligjore të procedurave që kanë të bëjnë me ekzekutimin e letër-porositë të ndryshme si për ato të ardhura nga jashtë vendit tonë në adresë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ashtu dhe për ato letër-porosi që janë dërguar nga ky institucion jashtë

Konkretisht përgjatë vitit 2023 nga seksioni i ekzekutimit të vendimeve penale Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës janë dërguar për ekzekutim për jashtë vendit tonë **48** letër-porosi, ndërsa nga jashtë vendit tonë për llogari ekzekutimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kanë ardhur dhe janë ekzekutuar **38** letërporosi.

### **-Transferimet e procedimeve penale /të personave të dënuar**

Përgjatë vitit 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka pasur 4 raste të transferimeve të personave të dënuar konkretisht drejtë autoriteteve të drejtësisë së Kosovës, ndërkohë që nuk pasur asnjë rast të transferimeve të procedimeve nga jashtë.

### **-Shpalljet në kërkim ndërkombëtar/ heqjet nga kërkimi ndërkombëtar**

Njëkohësisht përgjatë vitit 2023 nga seksioni i ekzekutimit të vendimeve penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës janë përpiluar dhe dërguar për ekzekutim 11 Vendime “Për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”




të cilat janë lëshuar në adresë të personave të dokumentuar si autorë të veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, ndërkohë që janë hequr nga kërkimi ndërkombëtar 5 persona.

**VI. Të dhënat për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore****NGARKESA E PUNËS SË PROKURORËVE GJATË VITIT 2023**

Gjatë vitit 2023, nga ana e Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është përballuar një ngarkesë pune e konsiderueshme e çështjeve penale dhe gjykimeve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ashtu siç edhe e kemi trajtuar në pikën e parë të këtij raporti (Analize), rezulton se nga prokurorët është hetuar një numër më i madh çështjesh penale se ato të regjistruara gjatë gjithë vitit 2022. Më konkretisht po japim në një tabelë përmbledhëse të dhënat e ngarkesës së secilit prokuror dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

Nr.	Prokurori	Totali	Pushuar	Gjykatës	Pezulluar	Transferuar	Në hetim
1.	<b>T.Rrudha</b>	430	20	69	106	0	<b>235</b>
2.	<b>P.Deçolli</b>	484	18	102	102	3	<b>259</b>
3.	<b>F.Reka</b>	364	14	89	65	2	<b>194</b>
4.	<b>G.Veizi</b>	449	46	100	157	5	<b>141</b>
5.	<b>S.Nishani</b>	364	14	66	87	3	<b>194</b>
6.	<b>M.Kullolli</b>	208	21	30	32	1	<b>124</b>
7.	<b>M.Meta</b>	362	37	63	52	9	<b>201</b>
8.	<b>E.Kurti</b>	226	28	57	31	5	<b>105</b>
9.	<b>O.Cifliku</b>	187	35	57	18	5	<b>72</b>
10.	<b>A.Bramo</b>	150	29	17	26	1	<b>77</b>
11.	<b>A.Pali</b>	123	8	8	15	2	<b>90</b>
12.	<b>I.Hoxha</b>	130	15	12	12	1	<b>90</b>
13.	<b>E.Hysenaj</b>	118	5	11	18	0	<b>84</b>
14.	<b>R.Fishta</b>	134	11	10	34	3	<b>76</b>
15.	<b>E.Koloshi</b>	175	27	40	32	5	<b>71</b>
16.	<b>E.Shehu</b>	235	10	76	49	2	<b>98</b>
17.	<b>S.Beluli</b>	76	2	7	0	1	<b>66</b>
18.	<b>A.Bebeçi</b>	99	10	31	5	0	<b>53</b>
19.	<b>G.Copa</b>	138	19	43	16	1	<b>59</b>
20.	<b>A.Jella</b>	26	3	10	10	1	<b>2</b>
21.	<b>A.Felaj</b>	36	2	6	28	0	<b>0</b>
22.	<b>A.Shehu</b>	55	16	19	20	0	<b>0</b>
23.	<b>B.Bejko</b>	40	9	19	10	2	<b>0</b>
24.	<b>D.Pali</b>	60	15	30	15	0	<b>0</b>
25.	<b>E.Xhengo</b>	95	15	38	18	6	<b>18</b>
26.	<b>N.Troplini</b>	84	20	33	29	2	<b>0</b>
27.	<b>Xh.Hako</b>	4	0	0	2	2	<b>0</b>



### NGARKESA E PUNËS SË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE GJATË VITIT 2023


Përsa i përket ngarkesës së punës së Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2023 ajo paraqitet si në tabelën<sup>3</sup> e mëposhtme:

Nr .	Oficeri i Policisë Gjyqësore	Seksioni	Nr.çështjeve trajtuar	Statusi				
				Pushuar	Pezulluar	Dërguar gjyqit	Mbartur 2023	Tjetër
1.	Kimet Dyrmishi	I Përgjithshëm	98	18	7	23	48	2
2.	Adrian Gashi	I Përgjithshëm	90	9	12	22	47	0
3.	Ilir Ndrea	I Përgjithshëm	122	19	11	26	64	2
4.	Anita Mataj	I të Miturve & Ekzekutimet e Vendimeve Penale	154	36	10	61	47	0
5.	Elisa Xhetani	Posacëm Pastrimi Parave, Krimi Financiar, Hetimi Pasuror	93	18	4	17	50	4
6.	Bukuroshe Dollaku	Shpërdorimi i detyrës, Veprave Penale të Trafikeve dhe Narkotikëve	138	17	1	54	66	0
7.	Ogerta Manushi	Shpërdorimi i detyrës, Veprave Penale të Trafikeve dhe Narkotikëve	61	7	7	16	31	0
8.	Kreshnik Braho	I Përgjithshëm	12	0	2	2	8	0
9.	Gezim Gashi	I Përgjithshëm	105	15	23	45	22	0
10.	Erind Gjoni	Posacëm Pastrimi Parave, Krimi Financiar, Hetimi Pasuror	126	15	12	19	80	0
11.	Leonora Ndreu	I të Miturve & Ekzekutimet e Vendimeve Penale	44	2	9	18	15	0

<sup>3</sup> Tabela është e plotësuar me të dhënat e depozituara nga o.p.gj. sipas Aneks 3 të ligjit përkatës.

12.	Erin Caku	Posacëm & i Veprave Penale të Trafiqueve	196	20	100	47	28	1
13.	Mirzan Veli	I Përgjithshëm	66	2	2	11	51	0
14.	Eni Kodra	I Përgjithshëm	53	4	9	12	26	0
15.	Gestian Alia	I përgjithshëm	11	0	0	0	11	0
16.	Oltjon Ahmeti	I Përgjithshëm	36	3	12	9	12	0
17.	Arbnor Shehu	I përgjithshëm	19	0	1	0	18	0
18.	Olsi Peto	I përgjithshëm	59	4	5	12	38	0
19.	Arjan Vogli	I përgjithshëm	143	6	30	32	75	0
20.	Ardian Elezi	I përgjithshëm	101	8	20	34	39	0
21.	Flori Bajramaj	I përgjithshëm	126	22	48	34	22	0

Grafiku i mëposhtëm paraqet ngarkesën e punës të Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2023:



- Në lidhje me ngarkesën e oficerëve të policisë gjyqësore duhet theksuar fakti se, disa nga opgj kryejnë veprime edhe në fusha të tjera të cilat po i rendisim më poshtë:
1. O.p.gj. Kreshnik Braho kryen veprime lidhur me praktikat e urdhërave të ekzekutimeve penale.
2. O.p.gj. Anita Mataj kryen letërporosi, raporte si dhe hedhjen dhe përpunimin e të dhënave ne evidencën për ekzekutimet e dënimeve.
3. O.p.gj. Bukuroshe Dollaku hedh dhe përpunon të dhënat për çështjet me veprime proaktive.
4. O.p.gj. Elisa Xhetani hedh dhe përpunon të dhënat për sequestrot preventive/konservative.
5. O.p.gj. Leonora Ndreu kryen paralajmërime dhe veprime lidhur me praktikat e urdhërave të ekzekutimeve penale.

## VII. Informacion mbi administrimin dhe veprimtarinë administrative të prokurorisë

Lidhur me administrimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është për t'u theksuar fakti se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në bazë të strukturës së dërguar nga ana e Sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme ka të parashikuar në organikën e saj një trupë prej 34 prokurorësh, ku përfshihen një Drejtues, një Zëvendës Drejtues, dhe 32 prokurorë sektori. Por gjatë vitit 2023 kanë qenë efektivë në detyrë 21 prokurorë dy prej të cilëve të caktuar përkohësisht në apel, tre prokurorë janë shkarkuar, pra gjithsej 16 prokurorë për një periudhë prej tre muajsh pasi në tetor janë transferuar në këtë prokurori 6 prokurorë (tre prokurorë janë transferuar në Prokurorinë e Tiranës). Po kështu dhe 22 oficerë të policisë gjyqësore.

Mungesat e prokurorëve për shkaqet që arsyetuar më lart, kanë ndikuar dukshëm në mbartjen e një numri më të lartë procedimesh penale në krahasim me vitin 2022 krahas faktorëve të tjerë objektivë dhe subjektivë që kanë ndikuar në situatën aktuale. Në këtë kontekst çmohet se duke marrë në konsideratë ngarkesën në rritje nga viti në vit të procedimeve penale dhe të materialeve kallëzuese, por dhe natyrën e tyre është e nevojshme të shtohet numri i prokurorëve. Po kështu duke analizuar dhe sfidat e kohës ku gjithmonë e më shumë po vihet theksi dhe kërkohet një angazhim sa më i madh i Prokurorëve në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe atij ekonomiko-financiar, kundër krimit të organizuar, dhe një sërë veprash penale të një karakteri të rëndësishëm në veçanti vlerësojmë se për përballimin e këtyre sfidave duhet një numër më i madh prokurorësh efektivë në punë për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës. Kjo për shkak se jemi të ndërgjegjshëm se volumi i tepërt në punë ndikon dhe në cilësinë e saj.

Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, janë organizuar seksione për kategori të caktuara veprash penale, në përbërje të të cilëve janë caktuar jo më pak se tre prokurorë. Kështu janë krijuar dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre Seksioni për hetimin e veprave penale me persona të mitur, për Ekzekutimin e e Vendimeve penale të formës së prerë. Ky seksion ka mbuluar në veprimtarinë e tij dhe kërkesat në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë. Gjithashtu, janë krijuar dhe tre seksione të tjera, Seksioni për hetimin e krimit Ekonomik, Financiar dhe Kibernetik, Seksioni i Posaçëm Kunder Pastrimit të Parave , Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve pasurore (si rrjedhojë e krijimit të SPAK dhe kalimit të një numri të madh procedimesh dhe hetimesh pasurore) si dhe Seksioni për hetimin e krimeve të përgjithshme. Për secilin nga tre seksionet në zbatim të nenit 21/2 të ligjit 97/2016 janë caktuar shefat e seksionit.

Disa herë puna e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore mbi bazën e kërkesës për informacion të Drejtuesit të Prokurorisë apo të drejtuesve të seksioneve ka qenë objekt i verifikimeve lidhur me çështje konkrete dhe sidomos për ato në kalim të afateve të hetimit të tyre duke lënë për çështje konkrete dhe udhëzime të karakterit jo të detyrueshëm sikurse përcakton ligji 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” në nenin 48 të tij.

Çdo prokuror në punën për hetimin e çështjeve penale është ndihmuar nga të paktën dy Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Durrës sipas ndarjes së caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka organizuar punën mbi bazën e planifikimit të rregullt mujor të gatishmërisë ditore për prokurorët të ndarë sipas seksioneve. Po kështu mund të themi se për pjesën dërrmuese të kohës shpërndarja e çështjeve sipas seksioneve është bërë mbi bazën e shortit elektronik, dhe vetëm në rast të mosfunksionimit të shortit elektronik, shpërndarja e çështjeve është bërë mbi bazën e shortit manual. Nga shorti janë përjashtuar çështjet e filluara kryesisht nga

prokurorët, ato të administruara jashtë orarit zyrtar të punës ose në ditët e pushimit, si dhe ato që kërkojnë veprime urgjente nga ana e Prokurorëve, duke iu caktuar atyre që kanë filluar çështjen kryesisht ose kanë qenë të gatshëm në ditët e administrimit të akteve, apo të cilët kanë kryer veprime urgjente me aktet hetimore.

Vlen të theksohet fakti se nga ana e drejtuesit janë nxjerrë disa urdhra për përjashtim nga shorti elektronik të prokurorëve që merrnin më shumë materiale hetimore. Shorti elektronik nuk mbante parasysh shpërndarjen në mënyrë të barabartë ditore, javore apo mujore, prandaj dhe nga ana ime është ndërhyrë me urdhra për përjashtim nga shorti me qëllim që të mos krijohet disbalancë e madhe në ngarkesat e prokurorëve. Raste përjashtimore kanë qenë në zëvendësimet e bëra për prokurorët e larguar, ku është vënë re një problematikë në shortimin jo të barabartë të materialeve dhe ka lindur nevoja e shortimit manual duke mbajtur procesverbalet përkatëse. Lidhur me kete problematike konstatoj se shortimi elektronik per ndarjen e ceshtjeve në rastet e zëvendësimeve nuk eshte e sakte pasi shorti dergon procedimet vetëm të prokurori i renditur i pari sipas alfabetit. Pra, për të gjitha dosjet e hedhura në short, dihet paraprakisht se cilit prokuror do ti kalojnë sipas alfabetit. Pra, nuk është një ndarje e drejtë, transparente dhe e padiktuar nga askush. Për zgjidhjen e këtij problemi jemi diktuar të aplikojmë shortin manual, deri ne rregullimin e sistemit Cams.

Ka patur një koordinim të mirë të punës përsa i përket lidhjeve dhe informacioneve ndërmjet prokurorëve dhe zyrës së regjistrimit lidhur me problematikën dhe përfshirjen e personave në kryerjen e veprave penale si dhe në mënyrën e plotësimit dhe hedhjes së të dhënave në regjistrin e njoftimit të veprave penale, por lind nevoja e një koordinimi më të mirë nga ana e prokurorëve në lidhje me çështjet e përfaqësimit në gjykim për masat e dënimeve me zyrën e regjistrimit, për të pasqyruar në mënyrë më të saktë dhe në kohë të të dhënave, paraqitja në kohë e të dhënave në lidhje me vendimet e Gjykatës për seancat paraprake si dhe paraqitja e urdhërave për regjistrimin e emrit të personit nën hetim. Gjithashtu, duhet theksuar puna e kësaj zyre në nxjerrjen e të dhënave në mbështetje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zyrë e cila gjatë vitit ka bërë të mundur verifikimin dhe kthimin brenda afateve të shpejta të përcaktuara në ligj të kërkesave për informacion për subjektet e rivlerësimit.

Çdo grup prokurorësh ka patur mbështetjen në infrastrukturë si dhe ndihmën e punonjësve të sekretarisë në përmbushjen e detyrave të tyre. Zyra e sekretarisë ka funksionuar rregullisht në lidhje me administrimin dhe protokollimin e materialeve të ardhura në prokurori dhe me komunikimet me institucionet dhe me subjektet e përfshira në procedimet penale.

Nga ana e Prokurorisë mund të aksesohet ne databazën e regjistrimit të gjendjes civile, regjistrimit të gjendjes gjyqësore, regjistrimit të ALUIZNI-t dhe Sistemin TIMS. Është shtuar aksesimi edhe në regjistrat ZVRPP dhe regjistrat noterialë .

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.623 datë 26.10.2019, mbi “Miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitim të shërbimeve publike”, punonjësit e caktuar kanë marrë masat e duhura mbi zbatimin dhe përmbushjen e saj me përpikmëri, duke i siguruar të gjithë shtetasve të drejtën për informim dhe shërbim cilësor.

### **VIII. Informacion në lidhje me gjetjet, problematikat dhe rekomandimet lidhur me zbatimin e hartës së re gjyqësore.**

Me datën 01.05.2023 ka filluar zbatimi i hartës së re gjyqësore dhe nga ana jonë është zbatuar Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 01 datë 26.01.2023 mbi “Masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm”.

Nga ana e ish Prokurorisë Kavajë nuk u realizua inventari i kërkuar dhe në këtë Udhëzim. Nga ana ime me Urdhrin nr. 19 datë 04.05.2023 u urdherua kryerja e një inventarizimi të

regjistrave, librave që pasqyrojnë veprimtarinë e ish prokurorisë Kavajë, si dhe të arshivës dhe asetëve materiale në përputhje me nenin 8/2 të Udhëzimit nr. 1/2023 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Gjatë mbartjes së akteve procedurale nuk pati problematika të tilla që të kenë cënuar këtë proces. Vështirësitë u konstatuan në faktin që njëri prej prokurorëve të ish Prokurorisë Kavajë u transferua në një rreth tjetër dhe procedimet e tij u hodhën në short në Prokurorinë e Durrësit. Por gjatë këtij procesi, u konstatua se të dhënat e mbajtura në Regjistrat e ish prokurorisë Kavajë shpesh nuk ishin pasqyruar në mënyrë të plotë, dhe nuk kishte të dhëna të mbajtura në mënyrë elektronike. Ky fakt ka sjellë vështirësi në raportimin e të dhënave statistikore, të dhënave të nxjerra në kuadër të procesit të vlerësimit të magjistratëve në KLP, por edhe në drejtim të pasjes së një numri faktik të procedimeve penale të cilat kanë qenë në hetim në momentin e bashkimit të Prokurorive.

Gjithashtu nuk ka patur pasoja në respektimin e garancive procedurale të subjekteve sa i përket masave të sigurimit me arrest apo afateve të hetimit. Mund të ketë patur disa raste të shtyrjes së seancave gjyqësore për shkak të hedhjes në short të çështjeve penale të prokurorit Durim Bedini i cili është transferuar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasanit.

Ky riorganizim, ka ndikim në efincën e punës në prokurori, në drejtim të shpejtësisë së hetimit të çështjeve që vijnë nga Komisariati I Policisë Kavajë. Është fakt që nga kjo prokurori janë vetëm 2 prokurorë të transferuar në Prokurorinë e Durrësit, nga 3 që ka patur ish prokuroria Kavajë. Në këto kushte, në muajt maj tetor jemi përballur me shkarkime prokurorësh, si dhe mungesa të tjera për shkak të lëvizjeve paralele të disa prokurorëve, kemi patur ngarkesë shumë të lartë, e cila pasqyrohet edhe në numrin e çështjeve të mbartura.

Lidhur me nevojën për infrastrukturë dhe logjistikë, kemi përdorur logjistikën e ish prokurorisë Kavajë, tavoplina, karrige, dollapë etj, Gjithashtu ju bëj me dije se sic ju kemi vënë në dijeni nuk kemi ambiente për të akomoduar staf tjetër për arsye se në këtë moment jemi në kushtet e mbingarkesës nëpër zyra (ka zyra me 5 sekretarë dhe zyra me 3 opgj). Jemi në pritje të zbatimit të marrëveshjes nga ana e Gjykatës për marrjen e disa zyrave në katin e parë të Godinës aktuale në këmbim të zyrave në ish prokurorinë e Apelit Durrës, por që ende nuk është vënë në zbatim nga ana e Gjykatës së Durrësit.

Plani buxhetor për vitin 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është zbatuar si më poshtë:

	Shpenzime Konkrete/ në lekë	Fondi i Pagave dhe sig. shoqërore /në lekë	Shpenzim mbi Mallra, Riparime Ekspert/ në lekë	Mbështetje financiare	Shpenzime për Investime /në lekë
Plani	288.775.607	263.692.680	24.924.917	158.010	1.150.000
Fakti	285.867.571	263.523.765	22.185.796	158.010	1.055.232
Diferenca	2.908.036	168.915	2.739.121	0	94.768
%	98.99%	99.9%	89%	100%	91.7%

Problematikë që ekziston për disa vite me radhë, është mungesa e emërimit të një kancelari megjithëse nga ana ime është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme caktimi i një kancelari, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili është rrethi i dytë më i madh për sa i përket ngarkesës në punë dhe në personel. Caktimi nga KLP-ja sa më shpejt të jetë e mundur i një kancelari do të sillte përmirësim të dukshëm në organizimin dhe kryerjen e detyrave me karakter organizativ dhe financiar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

## **IX. Informacion për marrëdhëniet me publikun dhe mediat**

Marrëdhëniet me publikun në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë karakterizuar nga respektimi me korrektësi i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale si dhe ligjeve nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Nga ana e prokurorëve të çështjeve, është mbajtur në fokusin e punës së tyre, kthimi i përgjigjeve brenda afateve procedurale të kërkesave të palëve në proces apo personave të tjerë të interesuar.

Gjithashtu lidhur me kërkesat e bëra nga qytetarë të ndryshëm, me natyrë administrative apo juridiko-civile, edhe pse nuk janë objekt i kompetencave funksionale të organit të akuzës, është mbajtur në konsideratë një praktikë e tillë, duke i orientuar ata pranë institucioneve përkatëse si psh. Bashkia, IMT-ja etj, si dhe duke i kthyer përgjigjet me shkrim, për të cilat janë vënë në dijeni edhe këto institucione, me qëllim zgjidhjen e problematikave të evidentuara në funksion të respektimit të drejtave themelore të njeriut.

Në zbatim të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Prokurori për Median në bashkëpunim me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit i është përgjigjur me korrektësi kërkesave të ardhura në institucionin tonë, konkretisht duke trajtuar në total **60** kërkesa, shumica e të cilave kanë qenë të mediave të ndryshme. Kthimi i përgjigjeve në të gjitha rastet është bërë në përmbushje të plotë të afateve kohore të përcaktuara në ligj, me përjashtim të rasteve kur kthimi i përgjigjes ka kërkuar nxjerrjen e të dhënave me karakter voluminoz.

Gjithashtu vlen të përmendet që në rastet e çështjeve penale, me ndikim të ndjeshëm në komunitet, nga ana e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, në zbatimin të Programit të Transparencës janë publikuar edhe pa kërkesë të shtetasve të caktuar, të dhënat e hetimeve të kryera, gjithmonë në respektim të mbrojtjes së të dhënave personale.

Theksojmë se për vitin 2023, në asnjë rast e drejta për informim nuk është kufizuar si dhe nuk ka pasur asnjë ankesë nga individ apo media pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

## **X. Objektivat sipas drejtimeve në veprimtarinë administrative dhe funksionale të prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 dhe rekomandime**

Nga analizimi në tërësi e treguesve të punës së bërë nga ana jonë për vitin 2023 jemi të vetëdijshëm se ka vend për përmirësime të treguesve konkretë, si në hetim ashtu dhe në gjykim. Sa më sipër vlerësojmë se për të ardhmen do të jenë këto prioritetet tona kryesore:

- Ndjekja me përparësi e procedimeve penale të regjistruara për krimet e pastrimit të produkteve të veprave penale dhe krimet financiar, në fushën e krimet ekonomik, shpërdorimit të detyrës nga nëpunësit shtetërorë, korrupsionit, trafikeve të të gjitha llojeve, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, pasurisë, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj.
- Përmirësimi i cilësisë së hetimeve dhe shtimi rasteve të hetimeve proaktive, kryesisht për veprat penale në fushën e narkotikëve.
- Nxitja e prokurorëve për zbatimin e instrumenteve penale, siç janë urdhri penal, marrëveshja për pranimin e fajësisë, si dhe rritjen e rasteve të gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë.



- Forcimin e luftës kundër informalitetit duke rritur numrin e çështjeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për grupveprat në fushën e taksave dhe tatimeve si dhe rritjen e numrit të hetimeve paralele financiare.
- Nxitja e prokurorëve dhe opgj-ve për të rritur numrin e procedimeve penale të filluara kryesisht, veçanërisht lidhur me veprat penale sensitive për komunitetin.
- Rritjen e numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte /të ardhura si dhe shtimin e asetëve të sekuestruara/konfiskuara, si dhe për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval-it për pastrimin e parave/ luftimin e financimit të terrorizmit, bashkëpunimit me Eurojust.
- Rritjen e efektivitetit në hetimin dhe dërgimin për gjykim të veprave penale në fushën e mjedisit.
- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim rritjen e efektivitetit për hetimin e veprave penale të cilat janë prioritet për Prokurorinë e Durrësit.
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore në zbatim të Ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit të vendosur me strukturat drejtuese për shërbimet e policisë gjyqësore, në radhë të parë me ato të policisë së shtetit dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit paraprak.
- Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Rritja e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve.
- Ashpërsim të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.
- Përfundimi me sukses dhe mbrojtja e akuzës deri në fazën e gjykimit të çështjeve që lidhen me ngjarje të rënda kriminale të viteve të mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet policore.
- Nxitja e prokurorëve dhe opgj-ve për pjesëmarrjen në trajnime në fusha specifike sipas ndarjes së tyre në seksione në prokurori, me qëllim rritjen profesionale të tyre.

Në përfundim, duke vlerësuar se të dhënat e analizuar dhe problematikat e ngritura në këtë analizë pune për vitin 2023 do t'i shërbejnë si prokurorëve, ashtu edhe institucioneve të tjera përkatëse që lidhen me veprimtarinë tonë, dëshiroj të shpreh në emrin tim dhe të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të treguesve të punës së kësaj prokurorie.

**DREJTUESI I PROKURORISË**  
**ANITA JELLA**